



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT** **Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit**

Adresa: Rruga: Abdi Toptani nr.1, Tiranë;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 542/6 Prot.

Tiranë, më 29.07.2018

### **V E N D I M**

**Nr. 93, Datë 27.07.2018**

#### **PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t QARKU DIBËR “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”,për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.04.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Dibër, rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mangësive proceduriale në zbatimin e ligjshmërisë dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, nisur nga fakti se nga auditimi janë konstatuar shmangie, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### **VENDOSA**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Dibër, sipas programit të auditimit nr.542/1 prot., datë 07.05.2018, për veprimtarinë e kryer në periudhën nga data 01.01.2015 deri më 30.04.2018,**

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## **A.MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje:**Drejtoria Rajonale(DR) e ALUIZNI-t, Qarku Dibër nuk ka ndjekur procedurat ligjore për **331 dosjet e** dala nga arkiva të kualifikuara, duke shkelur afatet ligjore në kundërshtim me nenin 28, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me nenin 15, pika 4 të Rregullores nr.117, datë 14.07.2015, Urdhërit nr.546, datë 20.01.2016 dhe nr.37, datë 19.01.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Aluizni-t”, si dhe në kundërshtim me pikën 6 dhe 7 të “Matricës së procedurave dhe afateve për shqyrtimin administrativ për legalizim” (*Trajtuar në faqet 25-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër, të marrë masa për të ardhmen, duke proceduar dhe përfunduar sipas afateve të caktuara me përparësi në dhënien e lejeve të legalizimit për **331 dosje të kualifikuara** deri në vitin 2017.

**Brenda muajit Nëntor 2018**

**2. Gjetje:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër sipas pasqyrave të paraqitura, për 527 objekte, ka lëshuar leje legalizimi për objekte, pronarët e të cilave kanë përfutur një sipërfaqe totale **130,815.9m** , ndërkohë që duhej të likujdonin për parcelën ndërtimore vlerën **261,631,800 lekë** (130,815.9 m<sup>2</sup> x 2000 lekë për m<sup>2</sup>), ndarë afërsisht 50% me lekë dhe 50% bono privatizimi(lekë + bono privatizimi) ose **130,815,900 lekë dhe 130,815,900 bono privatizimi**, të cilat ngelen të pa arkëtuara(**261,631,800 lekë+bono privatizimi**). Kjo ka ardhur në mungesë të VKM-ve, si dhe mos përputhshmëri me kërkesat e pikës 5 e nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” **me zgjatje të procedurave dhe mos paraqitje të qytetarëve për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit.**

-Nga 527 objekte, për **491 objekte**, DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër **nuk ka përcjellë shkresat për pergatitjen e VKM-ve** dhe në dosjet e audituara nuk gjendet asnjë lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, pra me kohë vonesë nga **8 muaj deri në 2 vjet vonesë**, veprime në kundërshtim me Urdhërin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t me nr.546, datë 20.01.2016 dhe Urdhërin nr.37, datë 19.01.2016, si dhe në kundërshtim me ‘Matricën e procedurave dhe afateve për shqyrtimin administrativ për legalizim, “ pika 6 dhe 7 e kësaj matrice (*Trajtuar në faqet 30 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, të marrë masa për **491 dosje** dhe të nisë menjëherë shkresat për deklarimin e VKM-ve, me qëllim përshpejtimin në daljen e VKM dhe të likuidimit nga subjektet për ndërtimet informale të vleftës së parcelave ndërtimore prej **130,815,900 lekë dhe 130,815,900 bono privatizimi dhe krijuar impakt social pozitiv tek banorët e këtij qarku.**

**Brenda muajit Shtator 2018**

**3.Gjetje:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër, lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë në vlerën **26,517,252lekë**, nuk ka bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me bashkitë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos, në kundërshtim me nenin 27, germa (ç) të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe me VKM nr.411, datë 19.05.2010 “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar, për të cilat duhej të likuidohej taksa e infrastrukturës në vlerën **26,517,252 lekë si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit** (*Trajtuar në faqet 28 -38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:**Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër të marrë masa dhe të ndjekë plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Dibër, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimit e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej 26,517,252 lekë. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t të kërkojë pranë ZQRPP që të ushtrojë tagrin e tij ligjor mbi ZVRPP Mat e Dibër, për gjetjen e mundësive të detyrimit të qytetarëve dhe subjekteve për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.**

**Brenda muajit Nëntor 2018**

**4.Gjetje:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër, për 3 parcela me sipërfaqe totale gjithsej **267m<sup>2</sup>** në 3 zona kadastrale e vlerë **2,381,782 lekë**, nuk ka përfunduar procedurën ligjore të kompensimit të pronarëve. Pra nuk janë kompensuar dhe mbaruar procedurat e kompesimit per 3 dosjet, si dhe nuk ka ndjekje ritmike të procedurave ligjore, por janë konstatuar zgjatje procedurash me vite (*Trajtuar në faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër, në procesin e legalizimit të objekteve informale të ndjekë konform ligjit të gjithë objektet e ndërtuara në pronat e ish-pronarëve në afatet kohore të përcaktuara, për kompensimin e ish pronarëve për parcelat me sipërfaqe **267m<sup>2</sup> dhe në vlerën 2,381,782 lekë**, të cilat nuk janë kompensuar.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**5. Gjetje:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër, në **18 raste, në Zonën Kadastrale nr.2161, nr.2164, bashkia Klos, nr.1326, bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, bashkia Peshkopi, nr.8612, bashkia Bulqizë, për sipërfaqen e përgjithshme ndërtimore 1290.08 m<sup>2</sup>**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986004,dt. 16.07.2015, nr.986320, dt.12.05.2016, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr.986409, dt. 27.07.2016, nr.986433, datë 16.08.2016, nr.985935, dt. 17.05.15, nr.986048, dt. 12.05.15, nr.986100, dt. 23.11.15, nr.67178,dt. 11.07.13, nr.986502, dt. 20.09.2016,nr.987070, dt. 08.01.2018, nr.985017, dt. 28.10.17, nr.65359, datë 27.12.2012, nr.34466, dt. 24.09.12, nr.986509, dt. 06.10.16, nr.986456, dt. 02.09.16, nr.986149, dt. 12.02.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “**Ndërtesë**” dhe statutet juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, **konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janëpronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.**

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklaratat noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezulton të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore e qendrore, si dhe të njësive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet se ndërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZIONI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, prej **1334.08 m<sup>2</sup>**, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EK Banesave është 39,767 lekë/m<sup>2</sup> dhe sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016”, llogaritet në **51,334,423 lekë(1334.08 m<sup>2</sup> x 39,767 lekë/m<sup>2</sup> ). Vlera prej 51,334,423 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të ZQRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, ‘Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, neni 172 (Trajtuar në faqet 58 -98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **5.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër në Bashkëpunim me ZVRPP Mat e Dibër, të marrë masa:**

**a.** të vendosë masë kufizimi dhe të kërkohet arkëtimi i vlerës **51,334,423 lekë, si dëm ekonomik shtetit dhe përvetësimin e pasurisë publike në rrugë joligjore.**

**b.** të fillojnë procedurat në bashkëpunim me DP Aluizni-t Tiranë për anulimin e procesit të legalizimit deri në plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor.

**c.** për të ardhmen të merren masa dhe mos të lëshohen leje legalizimi për objekte pronë “Shtet” ose “PPV”, por të kërkojë dokumentim të saktë, të qartë dhe të hollësishëm nga ZVRPP-të, me përcaktim që nuk lë shteg për interpretim, shënime për llojin e pasurisë (zërin kadastral), sipërfaqen e parcelës ndërtimore, statusin juridik të parcelës dhe qartësisht faktin nëse ka apo jo ndërtime pronë “Shtet” ose “PPV”, brenda parcelës ndërtimore, pra të kërkohet plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor.

**Brenda muajit Shtator e në vijimësi**

**6.Gjetje:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër, në 5 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, 1326, 2592, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; nr.986304, dt. 20.04.16; 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986119, dt. 10.12.15; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë jo më pak se 10m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b” (Trajtuar në faqet 60 -90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër, të marrë masa për të ardhmen duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte në afërsi të rrugëve interurbane të kategorive “B” dhe “C”, duke ruajtur distancën e përcaktuar në Kodin Rrugor dhe legjislacionin për legalizimet.

**Në vijimësi**

**7.Gjetje:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër, në 7 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.3959, nr.1164, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.67178, dt. 11.07.13; nr.986777, dt.23.03.17;nr.986095, dt.12.11.15; nr.985936, dt.17.05.15; nr.34466, dt. 24.09.12;nr.986474, dt. 07.03.16; nr.987011,dt. 12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për një sipërfaqe **1763m<sup>2</sup> “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar 802m<sup>2</sup>**, ndodhen në afërsi të lumit Mat.Nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100ml, distancë që luhetet në segmentin 26m -9 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipër, nuk duheshin pranuar për legalizim **7 objektet** në sipërfaqen e përgjithshme prej: “Truall” 1763m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 802 m<sup>2</sup>.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55 (*Trajtuar në faqet 70-102 të Projekt-Raportit të Auditimit*).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër, të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat afër lumenjve, përrrenjve, rezervuarëve dhe brenda sipërfaqeve të tyre, në një distancë deri 100m dhe 100-200 m prej vijës së ujit, zona të cilat janë sipërfaqe pronë shtetërore të patjetërsueshme dhe të paparashkrueshme. Të bashkëpunohet me autoritetet e ujrave, duke marrë konfirmimin e tyre lidhur me këto distanca, varësisht nga situata topografike, pjerrësia e brigejeve, aktiviteti shumëvjeçar i ujrave (lidhur me përmytjet) etj. Leja mund të lëshohet pas konfirmimit pozitiv të autoriteteve të ujit.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **34 raste**, ka lëshuar lejet e legalizimit: Nr.986008, dt.16.07.16; Nr.986408, dt.27.07.16; Nr.986433, dt.16.08.16; Nr.986935, dt.17.05.15; Nr.986939, dt.17.05.15; Nr.986048, dt.13.08.15; Nr.986100, dt.23.11.15, nr.95934 ,datë 06.05.2015, nr.95933 ,date 10.05.2015, nr.9858891, datë 01.03.2015, nr.9888338 datë 03.06.2016, nr.986066 datë 28.09.2015, nr.995043 datë 30.06.2015, nr.986102 datë 23.11.2015, nr.995945, datë 20.06.2015, nr.995944 datë 30.06.2015, si dhe në **18 raste të tjera**, leje për godina banimi, në të cilat u konstatua se: **sipërfaqja e parcelës ndërtimore tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit**, në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “*Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>*”.

Kjo sipërfaqe e tepërt, është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por që gjithsesi i ka kaluar në pronësi me anë të lejes së legalizimit. Sipërfaqja që është dhënë tepër mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a dhe pikën 1/c .**Sipërfaqja mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit është 3899 m<sup>2</sup>**.

Në zbatim të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/c, për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, atëherë diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit, duhet **të llogaritet me vlerën e përcaktuar** në VKM nr.514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr.89, datë 03.02.2016.

Vlera prej **6,538,086 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë “Shtet” për godina banimi, të shitur subjekteve informale, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit(*Trajtuar në faqet 80 -100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1.Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër, të marrë masa:

**a.** për të rillogaritur siperfaqet tepër mbi trefishin e bazës së ndërtimit dhe të llogaritë vlerën e detyrimit **6,538,086 lekë s idem ekonomik shtetit**, që rezulton për çdo përfitues me çmimin e tregut miratuar me VKM dhe në bashkëpunim me ZVRPP Mat e Dibër të kërkohet arkëtimi i kësaj difference të papaguar nga 34 personat e subjektet perfitues (*sipas listës që është në Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

**b.** Për të ardhmen të mos lëshohet asnjë leje legalizimi për objekte e ndërtime informale, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Për rastet kur

lejon konfiguracioni, pasi të merret deklaratë noteriale nga aplikuesi, mund të shitet pjesa mbi 3-fishin, me çmimin e tregut (vlerën e pronës) në zonën përkatëse ku gjendet objekti.

### Menjëherë e në vijimësi

**9. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **1 rast**, sipas lejes së legalizimit nr.996414 datë 28.07.2016, ka kryer legalizimin e objektit, në një kohë qësipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë” zona informale, këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT. Pra legalizimi është kryer në zona “**Territore të tjera**”, për të cilat nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11 dhe 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.515, datë 13.05.2009 e VKM nr.589, datë 10.9.2014 “*Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale*” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, **duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” (Trajtuar në faqet 80 -130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**9.1. Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos kryer e lëshuar leje legalizimi, në rastet kur legalizimi është në zona “Territore të tjera”,zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT.

### Në vijimësi

**10. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **2 raste**, sipas lejeve të legalizimit nr.75832 datë 13.10.2014 dhe nr.985968 datë 26.11.2015, ku objektet janë ndërtuar me distancë 0.9m duke shkelur trupin e rruges kryesore dhe trotuarin, kur gjerësia e rrugës është 6m.

Veprimet e kryera bien në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 “*Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje*”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj” dhenë kundërshtim me VKM 502 date 13.07.2011 i ndryshuar si dhe nenin39të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, i ndryshuar (Trajtuar në faqet 75 -110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte të cilat shkelin trupin e rrugës kryesore, pra jashtë kufizime të caktuara nga ligji dhe aktet e tjera nënligjore.

### Në vijimësi

**11. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **1 rast**, sipas lejes së legalizimit nr.986070 datë 09.10.2015, poseduesi ka ndërtuar objektin dy katësh sipas dokumentave kostatohet se objekti ka qënë në ndërtim sipas kërkesës nga proceduesi në kërkesën më nr.98 prot., datë 11.07.2013.

Në provesverbalin e datës 10.10.2014 rezulton dhe skicat që tregojnë se objekti ka qënë i pa përfunduar, nuk pasqyrohet me foto të tjera, **nuk ka asnjë dokument ligjor ku të argumentojë se objekti ka qënë i ndërtuar para vitit 2014**, nuk ka dokument nga ujësjellësi ose nga KESH për këtë objekt, por kanë marrë një vërtetim nga Bashkia ku cilësohet se: “Ky objekt ka qënë ndërtuar në vitin 2008” **ndërsa fotot e vitit 2013 tregojnë të kundërtën.**

Këto veprime janë kundërshtim me nenin 2 pika “a” dhe “i”, nenin 17 pika 3, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 me ndryshime; ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, VKM nr.589, datë 10.09.014 pka 1 dhe 2; VKM nr.438 datë 28.06.2006 ndryshuar me VKM nr.994 date 06.10.2010, me ndryshime;VKM nr.280,datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu I, pika b, si dhe kreu i I pika 2,6 dhe 8 Udhëzimi nr.1451, datë 07.10.2015 (Trajtuar më hollësisht në faqet 120 -160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte, të cilat kanë qënë të pandërtuara, në ndërtim e sipër, në objekte

të cilat nuk kanë soletat e sipërme, në momentin e vetëdeklarimit dhe e konfirmuar me fotografi me datë.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **1 rast, në ZK nr.2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384,dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate,me adresë: Fshati“Ostren i Madh”, bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, Zona Kadastrale nr.2846, nr.Pasurie 1691/1, sipërfaqe e **parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe e ndërtimit 416m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit,në kushtet, kur sipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr.417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr.1755, datë 05.04.2016, “Kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr.1691, regjistruar në vol.8, faqe 182, të ZK 2846, bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, **ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”:5031m<sup>2</sup>**.

Në katë rast, nuk duhej të lëshohej leje e legalizimit, konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384,dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullimore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, nenet 10 dhe 17 (Trajtuar në faqet 85 -150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale të ndërtuara në sipërfaqe toke në zërin kadastral “Pyje”, “Kullotë” e “Livadhe”, sipas konfirmimit nga ZVRPP-të.

**Në vijimësi**

**13.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **78 raste**, në Zonat Kadastrale nr.2161, nr.1326, nr.2990, nr.2164, nr.1164,nr.1137,nr.1651, nr.2312,nr.1507,nr.2932, nr.2592,nr.1280, nr.8612, nr.1325,nr.1326, nr.2823,nr.2549, nr.3694,nr.3959, nr.8621,nr.1164, nr.1958,nr.8612, nr.2846, etj.,ka lëshuar lejet e legalizimit:

nr.986004, dt.16.07.2015; nr.986320, dt. 12.05.2016; nr.986334, datë 01.06.2016; nr.986408, dt. 27.07.2016; nr.986409, dt. 27.07.2016; nr.986433, datë 16.08.2016; nr.985935, dt.17.05.15; nr.985939,dt.17.05.15;nr.986048,dt.12.05.15;nr.986100,dt.23.11.15;nr.986502,dt.20.09.2016; nr.987070,dt.08.01.2018;nr.985017,dt.28.10.17; nr.986777, dt.23.03.17; nr.986917, dt.09.07.17; nr.986147, dt. 10.02.16; nr.986901,dt.25.06.17; nr.986688, dt.11.07.16; nr.986932, dt. 26.07.17; nr.986656, dt. 26.12.16;nr.986304, dt.20.04.16;nr.985890, dt. 31.03.15; nr.985956, dt. 30.06.15; nr.985866, dt.08.01.15; nr.986357, dt.15.08.16; nr.987836, dt.28.02.18; nr.986095, dt.12.11.15; nr.986181, dt.21.03.16; nr.986838, dt. 16.05.17; nr.21062, dt. 09.06.12; nr.986141, dt.26.01.16; nr.986125, dt.21.12.15; nr.985954, dt.30.06.15; nr.986139, dt.26.01.16; nr.986139, dt.26.01.16; nr.986431, dt.11.08.16; nr.986602, dt.28.11.16; nr.986348, dt. 09.06.16; nr.986998, dt.22.09.17; nr.986104, dt.25.11.15; nr.986895, dt.22.06.17; nr.986936, dt.27.07.17; nr.986926, dt. 25.07.17; nr.986185, dt. 21.03.16; nr.986294, dt.10.04.16; nr.986509, dt.06.10.16;nr.986456, dt. 02.09.16; nr.987010, dt. 13.10.17; nr.986364, dt.20.06.16; nr.986483, dt.24.09.16; nr.986462, dt.08.09.16; nr.986111,dt.04.12.15;nr.986474, dt.07.03.16;nr.986149,dt.12.02.16;nr.986169,dt.07.03.16;nr.986119, dt.10.12.15;nr.986137, dt.25.01.16; nr.986697, dt.28.01.17;nr.987011,dt.12.10.17; nr.985889,dt. 21.03.15; nr.986046,dt. 10.08.15;nr.986349,dt. 10.06.16;nr.986384,dt. 13.07.16; nr.986908,dt. 15.07.17, nr.996414dt.28.07.2016,nr.95934,dt.06.05.2015,nr.95933,datë10.05.2015,nr.9858891,dt.01.03.2015,nr.9888338,dt.03.06.2016,nr.986725,dt.21.02.2017, nr.995043 dt.30.06.2015,nr.986102 dt.23.11.2015,

në kushtet e mungesës së inventarëve përkatës të këtyre dosjeve, sipas dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me ligjin nr.9154, date 06.11.2003, “Për arkivat” (*Trajtuar në faqet 90 - 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër të marrë masa, duke plotësuar me inventarin e dosjes **78 rastet e përmendura më sipër**, si dhe të gjithë dosjet që janë të painventarizuar e në të ardhmen ky proces të kryhet menjëherë pas lëshimit të lejes së legalizimit.

**Menjëherë**

**14. Gjetje:**DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **7 raste**, në Zonat Kadastrale **nr.2161, nr.2312,,** ka lëshuar lejet e legalizimit nr.986004, dt.18.07.2015; nr.986095, dt.12.11.2015; nr.986141, dt. 26.01.2016; nr.986125,dt.21.12.2015;nr.985954,dt.30.06.2015;nr.986139,dt.26.01.2016;nr. 986134, dt.10.01.2016;nr.986104, dt.25.11.2015, **në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës.** Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, shkronja “dh” (*Trajtuar në faqet 110 -160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1.Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale, në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në **4 raste**, në zonat kadastrale **nr.2161 Klos dhe nr.8612 Bulqizë**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.985935, dt.17.05.2015, nr.986048, dt.12.05.2015, nr.986181, dt.21.03.2016, nr.986895, dt. 22.06.2017, **në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër**, në kundërshtim me VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 42;

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27;

- UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, pikat 2 e 3;

-VKM nr.258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” (*Trajtuar në faqet 100 - 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë dhe kur nuk ka përgjigje nga ZVRPP-të për këtë çështje.

Në këto raste, të kërkojë dokumentim të saktë, të qartë dhe të hollësishëm nga ZVRPP-të, me përcaktim që nuk le shteg për interpretim, shënime për llojin e pasurisë (zërin kadastral), sipërfaqen e parcelës ndërtimore, statusin juridik të parcelës dhe qartësisht faktin nëse ka apo jo ndërtime pronë “Shtet” ose “PPV”, brenda parcelës ndërtimore, në të kundërt të mos lëshojë leje legalizimi.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, në rastet si mëposhtë:



- **Në 8 raste**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave (truall + ndërtesë) të cilat kanë rezultuar me pronësi “Shtet” ose pronë e të tretëve, e për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit me nr.986612, datë 06.12.2016, nr.986003, datë 16.07.2015, nr.986506, datë 03.10.2016, nr.986931, datë 26.07.2017, nr.986638, datë 21.12.2016, nr.9878916, datë 30.04.2018, nr.986877, datë 04.07.2016 dhe nr.986564, datë 14.11.2016 rezulton se këto pasuri. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”.

- **Në 1 rast**, me leje legalizimi me nr.986506, datë 03.10.2016, për një pallat 9 kate, u konstatua se sipërfaqja e parcelës ndërtimore prej **1123 m<sup>2</sup>** është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a. Pra ligji e ndalon në mënyrë kategorike miratimin kalimit të drejtës së pronësisë për sipërfaqet mbi 500m<sup>2</sup> e për pasojë sipërfaqja prej **623m<sup>2</sup> truall është dhënë mbi normën e përcaktuar me ligj**. Po ashtu me anë të kësaj leje legalizimi në zonë informale të pa miratuar nga KRRTRSH/KKT është miratuar legalizimi për objektin “**Pallat 9 kate**” dhe është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore, të regjistruar në ZVRPP në zërin kadastral “Pyll”, duke ndryshuar zërin kadastral nga “Pyll” në “Truall” pa miratimin e autoriteteve përkatëse. Legalizimi i këtij objekti është kryer në zonë “Territore të tjera”, për të cilën nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

- **Në 10 raste**, janë legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej 20 m, 21 m, 27m, 28 m, 33 m, 35 m, 37 m, 56 m, 57 m dhe 89 m pranë bregut të lumit, pra më pak se **distanca** e lejuar prej 100 metrash. Për sa më lartë lejet e legalizimit me nr.9396, datë 10.04.2012, nr.985937, datë 17.05.2015, nr.987000, datë 06.10.2017, nr.986002, datë 16.07.2015, nr.965821, datë 23.07.2013, nr.986999, datë 06.10.2017, nr.985905, datë 31.03.2015, nr.986907, datë 03.07.2017, nr.986631, date 20.12.2016 janë miratuar në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

- **Në 11 raste**, janë legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik). Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Për sa më lartë lejet e legalizimit me nr.986863, datë 23.05.2017, nr.986598, datë 26.11.2016, nr.986931, datë 26.07.2017, nr.986638, datë 21.12.2016, nr.986625, datë 15.12.2016, nr.986682, datë 25.01.2017, nr.986563, datë 14.11.2016, nr.986606, datë 28.11.2016, nr.9878916, datë 30.04.2018, nr.986877, datë 04.07.2016 dhe nr.986564, datë 14.11.2016 janë miratuar në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

- **Në 4 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se objektet e legalizuar me lejet e legalizimit nr.985900, datë 31.03.2015, nr.986003, datë 16.07.2015, nr.986904, datë 30.06.2017, nr.986340, datë 03.06.2016, **ndodhen në distanca prej 2m deri në 6m nga rruga e kategorisë C**. Në këto raste objektet nuk duhet të legalizohen sepse çënojnë dhe shkelin distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 I ndryshuar.

- **Në 1 rast**, me leje legalizimi nr.986638, datë 21.12.2016, është legalizuar një objekt i cili nga verifikimi i hartës dixhitale me anë të google earth rezulton se nuk ishte ndërtuar ende deri në datën 27.06.2014, datë e cila është e përcaktuar në fushën e zbatimit të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 2 “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”. Pra **ndërtesa e legalizuar nuk është objekt i ligjit e për pasojë nuk duhet të ishte legalizuar**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- **Në 1 rast**, është dhënë leja e legalizimit nr.986035, datë 31.07.2015, për “Shtesë në lartësi” **duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë është dhënë në tejkalim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër **duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet” e krijuar problem sociale**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- **Në 1 rast**, me leje legalizimi nr.986034, datë 31.07.2015, është legalizuar shtesa anësore 1-kat, me sipërfaqe 29.4m<sup>2</sup>, në ZK1326, pasuria nr.4/431, e cila sipas fotove të deklaruesit **paraqitet karabina pa mbulesë me çati apo soletë**. Leja e legalizimit është miratuar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- **Në 12 raste**, me lejet e legalizimit nr.986598, datë 26.11.2016, nr.986331, datë 01.06.2016, nr.985951, datë 30.06.2015, nr.986083, datë 26.10.2015, nr.986099, datë 23.11.2015, nr.985966, datë 15.07.2015, nr.986030, datë 30.07.2015, nr.986112, datë 04.12.2015, nr.986297, datë 16.04.2016, nr.986088, datë 27.10.2015, nr.986584, datë 22.11.2016, nr.986052, datë 08.09.2015, janë dhënë leje legalizimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej 1461.9m<sup>2</sup> në total mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit dhe duke i ndryshuar zërin kadastral nga “Arë” në “Truall”, në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a (*Trajtuar më hollësisht në faqet 120 deri 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër për **49 rastet** e trajtuara më sipër të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e këtyre lejeve të legalizimit, pasi procedura e legalizimit të këtyre objekteve informale dhe pajisja me leje legalizimi, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**Brenda muajit Shtator 2018**

**17. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi nr.0025567, datë 06.02.2016, për ndërtimin informal “godinë shërbimi 1-kat”, lagjia “Treg” Peshkopi, pasuria 22/104, ZK 2932, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 92 m<sup>2</sup>, sipërfaqe njolle 35,7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale ndërtimi 35.7 m<sup>2</sup>, rezultoi se: **Leja e legalizimit datë 06.02.2016 është dhënë në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pasi:**

- ndërtimi informal është ndërtuar në rrëpirën e përroit,

- ndërtimi informal nuk ka themele, por qëndron mbi trarë hekuri me rrezik shembje,

- ndërtimi informal ndodhet buzë rrugës kryesore kombëtare Peshkopi-Tiranë,

- mungon dokumenti për marrëdhënien me truallin dhe certifikata e pronësisë, pasi pasuria 22/104 është tokë lehdh (pjerrësi ose breg lumi), sipas shkresës ZVRPP Dibër nr.1591/1 datë 26.6.2015.

- leja e legalizimit nuk është nënshkruar nga përgjegjësi/specialist i legalizimit,

- mungon akt verifikimi në terren.

- është rritur sipërfaqja e parcelës ndërtimore 92m<sup>2</sup> nga 35,7m<sup>2</sup> që duhej, pasi sipërfaqja është rrëpirë deri në lum (*Trajtuar në faqet 80 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1. Rekomandimi:** DR Aluizni-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e saj, sepse është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pasi është objekt i ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "*Për inspektimin e ndërtimit*" i ndryshuar.

**Brenda muajit Shtator 2018**

**18. Gjetje.** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 14.9.2017, ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik, pasuria 23/142, ZK 2932, lagja treg ish-parku automobilistik i mallrave Peshkopi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 48m<sup>2</sup> me sipërfaqe ndërtimi 48m<sup>2</sup>, rezulton se: legalizimi i objektit informal 1-kat **cënon zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore, të unazës së qytetit**, sipas shkresës të bashkisë Peshkopi nr.4068/1, datë 7.9.2017, kjo në përgjigje të kërkesës të ALUIZNI-t nr.1636 datë 4.9.2017(*Trajtuar në faqet 90 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1. Rekomandimi.** DR Aluizni-t Qarku Dibër të marrë masanë bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin informal të pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e lejes të legalizimit, të dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, **pasi cënon zbatimin e projektit të unazës së qytetit**.

**Brenda muajit Shtator 2018**

**19. Gjetje:**Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 17.02.2016, shtesë anësore 1-kat *ngjitur pallatit ekzistues 4-kat*, Burrel, për parcelën ndërtimore shtet me sipërfaqe 32,6 m<sup>2</sup>, pasuria 2/335, ZK 1326, rezultoi se:

**a.** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër **ka përdorur 2 standarde**, pasi ka dërguar shkresë pushtetit vendor, për pasurinë 23/142, ZK 2932, ndërsa nuk ka dërguar shkresë për pasurinë nr.2/335, ZK 1326 nëse shtesa e objektit pengon planin rregullues të qytetit, ka zënë hapësirën publike ose ka shkelur distancat me kufitarët. Në fakt shtesa është mbi hapësirën publike dhe e cënon atë, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.50/2014. Kështu nuk janë zbatuar distancat e ndërtimit shtesë me pronën publike prej 0,6 metër larg në gjitha anët, në kundërshtim me nenin 62 të rregullores së urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405 17.9.1998 i ndryshuar me ligjin nr.10119, datë 23.4.2009 "*Për planifikimin e territorit*",mungojnë deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të legalizohet.

**a.**Disponohet dëshmia e trashëgimisë datë 05.01.2006 për kalimin e pasurisë në emër të birit, por i ati nuk është pronar, pasi **nuk ka certificate pronësie**(*Trajtuar në faqet 85 -118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e saj, pasi është dhënë në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi ndodhet mbi hapësirën publike.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**20. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 13.12.2017, për ndërtimin informal "*shtesë 1-kat ne objektin ekzistues 1-kat për aktivitet*" Maqellarë, pasuria 60/27/1, ZK 1384, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 51m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale ndërtimi 51m<sup>2</sup> për aktivitet, rezultoi se:

**-dhënia e lejes legalizimit datë 13.12.2017 është dhënë në mënyrë të paligjshme, pasi shtesa është ngjitur objektit ekzistues pikë karburanti dhe paraqet rrezik zjarri,** sipas dokumentit KPP të ZVRPP Dibër, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me VKM nr.756 datë...10.2016 pika 2 /gj dhe 3,

**-nuk ka leje mjedisore,** për ndërtimin informal ngjitur pikës karburantit dhe mungon kordinimi me pushtetin lokal, zyrën e urbanistikës, drejtorinë bujqësisë dhe agjencitë mjedisore, në kundërshtim me nenin 10/d të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar (Trajtuar në faqet 100 - 119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e saj, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi ndodhet ngjitur pikës karburantit me rrezikshmëri zjarri.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**21. Gjetje:** Nga auditimi i dosjes me leje legalizimi datë 27.09.2016, për ndërtimin informal “ngritje 1-kat shërbimi mbi godinën ekzistuese 1–kat” Maqellarë, pasuria 755/2, ZK 2592, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 47,9 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 20,2 m<sup>2</sup> numri i kateve 2, ku kati i II social paraqet sipërfaqe 30,6 m<sup>2</sup>, rezultoi:

**a. ndërtimi informal ka cenuar dhe zënë hapësirën publike,** pasi **hyrja në katin e dytë lokal ka zënë plotësisht trotuarin e këmbësorëve,** sipas plan-vendosjes, genplanit dhe fotos së terrenit, në kundërshtim me nenin 31/1/a/b dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015 dheme ligjin 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 dhe neni 4, me VKM nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të K. Rrugor në RSH” neni 25, pika 2.

**b. Dokumentacioni është i parregullt, kontradiktor, me ndryshim të dhënash,** konkretisht:

- vet deklarimi i subjektit 23.12.2014 flet për shtesë anësore ndryshe nga leja e legalizimit datë 27.09.2016 që flet për ngritje kati.

- leja e legalizimit datë 27.09.2016 dhe vërtetimi hipotekar datë 24.4.2001 paraqet sipërfaqen e ndërtimit njollë 20 m<sup>2</sup>, ndryshe nga procesverbali i verifikimit në terren datë 16.7.2015 që e pasqyron 30,6 m<sup>2</sup>, pra rezulton se ka edhe shtesë anësore për sipërfaqen 10,6 m<sup>2</sup> e pa dokumentuar në lejen e legalizimit.

**c. leja e legalizimit datë 27.09.2016 është dhënë para plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor,** pasi statusi juridik i pasurisë ka ardhur pas dhënies së lejes, sipas shkresës ZVRPP Dibër datë 30.9.2016, madje sipas kësaj shkrese pasuria 755/2, ZK 2592 flet për person tjetër A N etj dhe jo për M ShT (Trajtuar në faqet 95 - 109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor, të detyrojë subjektin të **prish hyrjen në katin e dytë lokal,** sepse ka zënë trotuarin e këmbësorëve, të fillojnë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimi, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**22. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 15.08.2017, për ndërtimin informal “ngritje 3-kat për banim mbi godinën ekzistuese 1–kat” Peshkopi, pasuria 11/158, ZK 2932, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 47,9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 20,2 m<sup>2</sup> numri i kateve 2 ku kati i II social paraqet sipërfaqe 30,6 m<sup>2</sup>, rezultoi:

**a.padrejtësisht është ndërtuar një hyrje me shkallë betoni**, për të lidhur nga jashtë katin përdhe me katin II të objektit, **çka ka cenuar hapësirën publike**, pasi ka zënë trotuarin e këmbësorëve ngjitur rrugës automobilistike, sipas plan vendosjes të paraqitur në genplan dhe fotos së terrenit, veprim në kundërshtim me me genplanin, me piken 2 të vendimit kualifikimit datë 19.7.2017, me nenin 31/1/a/b dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 , me VKM nr.280, datë 01.04.2015, me VKM nr.153, date 07.04.2000 neni 25, pika 2.

**b.ndërtimi informal 4 kat mbi tokë pasqyrohet për banim, në fakt ai është i kombinuar**, kështu leja e legalizimit datë 15.08.2017 dhe vendimi i kualifikimit datë 19.07.2017, paraqet kontradikta me planimetrinë e kateve, fotot dhe akt ekspertizën e objektit.

**c. mungon akt kontaktimi në terren**, por është mjaftuar me disa skica të parregullta dhe pa asnjë nënshkrim të specialisteve, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*, pika 36(*Trajtuar në faqet 75 -105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor të detyrojë subjektin **për prishjen e shkallëve shtesë** jashtë objektit, duke e pasqyruar në procesverbal, si dhe të plotësojë dosjen me dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e saj.

**Brenda muajit Nëntor 2018**

**23. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 20.12.2016, për ndërtimin informal “*shtesë anësore + ngritje 1-kat për shërbim, në godinën ekzistuese 1–kat*” Klos, pasuria 1/436/1, ZK 2161, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 199 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 167,9 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale ndërtimi për aktivitet 230,9 m<sup>2</sup>, rezultoi:

**a.ndërtimi informal ka cenuar hapësirën publike**, pasi **hyrja në katin e dytë lokal ka zënë trotuarin e këmbësorëve** ngjitur me rrugën nacionale Tiranë Peshkopi, sipas fotove së terrenit, HTR dhe genplanit 14.10.2014, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.50/2014.

**b. proces verbali i konstatimit datë 28.10.2014 nuk pasqyron saktë kufitarët**, pasi rrugën nacionale e emërton rrugë lagje, kjo në kundërshtim me genplanin dhe HTR të objektit(*Trajtuar më hollësisht në faqet 80 deri 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor, të detyrojë subjektin **të prish shkallët që lidhin katin e dytë, pasi cënojnë hapësirën publike**, për objektin e pajisur me leje legalizimi, për pasurinë 1/436/1, ZK 2161, Klos.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**24. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 26.11.2015, për ndërtimin informal “*shtesë anësore + ngritje 2-kat e kombinuar, në godinën ekzistuese 1–kat*” Peshkopi, pasuria 14/26, ZK 2932, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 226 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 176,7 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale ndërtimi për banim 384,4 m<sup>2</sup> dhe 76,7 m<sup>2</sup> për aktivitet, rezultoi se:

**-ndërtimi informal ka cenuar hapësirën publike**, pasi **hyrja në katin e parë dhe dytë ka zënë sheshin e këmbësorëve** (*ngjitur rrugës nacionale*), sipas fotove së terrenit, HTR dhe genplanit, në kundërshtim me nenin 31/1/a/b dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*të ndryshuar*, me VKM nr.280, datë 01.4.2015, me ligjin 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar, neni 2 dhe neni 4, me VKM nr.153, date 07.04.2000 “*Për miratimin e rregullores zbatimit të KRRr në RSH*” neni 25, pika 2,

-mungojnë deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.50/2014, nenit 62 të rregullores së urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405 17.9.1998 i ndryshuar me nr.10119, datë 23.4.2009, nr.107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” dhe me VKM nr.502, datë 13.07.2011 i ndryshuar(*Trajtuar në faqet 95 - 108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**24.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor të detyrojë poseduesin të **prish shkallët që lidhin katin e parë dhe të dytë, pasi cenojnë hapësirën publike**, të plotësojë dokumentacionin ligjor të munguar, për objektin e pajisur me leje legalizimi, pasuria 14/26, ZK 2932, Peshkopi.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**25. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 28.07.2016, për ndërtimin informal “*shtesë kafazi i shkallëve 2-kat për banim, ngjitur me godinës ekzistuese 2-kat*” Peshkopi, pasuria 13/100, ZK 2932, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 14,5 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale ndërtimi 29 m<sup>2</sup> për banim, rezultoi se:

-**ndërtimi informal** i kufizuar në 2 anët me rrugë **ka cënuar sheshin hapësirë publike**, sipas genplanit të ALUIZNI datë 01.09.2015, procesverbalit terrenit 15.10.2014 dhe fotove të terrenit.

- **mungon statusi juridik i pasurisë**, në kundërshtim me nenin 27/dtë ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe nr.62/2015, pasi pasuria 13/100 është shesh publik, sipas shkresës ZVRPP nr.260/1, datë 5.02.2016 dhe nr.2030/1, date 30.9.2015. **Për rrjedhojë sheshet, lulishtet dhe rrugët nuk mund të kthehen në truall.**

Përfundimisht, shtesa është e ndërtuar mbi sheshin publik, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 01.04.2015.

- **objekti nga fillimi ka pësuar 3 herë shtesa informale nga viti 2006 deri 2013**, pra **informalitet mbi informalitet, çka ka nxjerrë jashtë funksionit qëllimin e ligjit legalizimit** (-godinë 1 kat ekzistuese, - shtese 1 kat mbi katin ekzistues- shtesë kafazi i shkallëve 2 kat ) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**25.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor të detyrojë subjektin **për prishjen e “shtesës kafazi i shkallëve 2-kat, ngjitur me godinës ekzistuese 2-kat”** Peshkopi, pasuria 13/100, duke e pasqyruar në procesverbal, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e saj, pasi shtesa është e ndërtuar mbi sheshin publik, në kundërshtim me dispozitat e ligjore.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**26. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 08.10.2017, për ndërtimin informal “*godine social-ekonomike 2-kat*” ,Maqellarë, pasuria 119/1/1, ZK 2592, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 62,4 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale ndërtimi 138,2 m<sup>2</sup> për aktivitet, rezultoi:

**a.** Leja legalizimit është dhënë në mënyrë të pa ligjshme, pasi objekti ndodhet në një distancë nga rruga nacionale Tiranë-Maqellarë me pak se përcaktimet ligjore, në kundërshtim me nenin 39 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” të ndryshuar, me kap.II/a të VKM nr.280, datë 01.04.2015, me Ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “*Kodi rrugor në RSH*”, neni 2 dhe neni 4, me VKM nr.153, datë 07.04.2000 neni 25, pika 2, si dhe me VKM nr.756 datë 10.2016 pika 2 /a/i, kapitulli II . Kështu sipas 3 gen planeve të vitit 2014 dhe 2015, ndërtimi informal 119/1/1 pasqyrohet mes pasurisë 2-kat nr.118 dhe pasurisë 3- kat nr.119/1. Sipas genplanit datë 13.11.2014 distanca e objektit nga rruga nacionale Tiranë-Maqellarë **pasqyrohet 1.25 metër nga 10 metër që duhej**. Procesverbal verifikimi në terren datë 13.11.2016 nuk përcakton distancat e objektit nga 4 kufitarët e tij, sidomos me rrugën nacionale Tiranë - Maqellarë (*Trajtuar në faqet 100-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**26.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi **të fillojë procedurat përshfuqizimin e saj**, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për*

*legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**27. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 13.06.2017, për ndërtimin informal “*Godinë për aktivitet 2-kat*”, lagjia “*Aksion*” Peshkopi, pasuria 18/125/1, ZK 2932, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup>, sipërfaqe njolle 25.6 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale ndërtimi 61,2 m<sup>2</sup> për aktivitet,rezultoi se:

**a.mungon statusi juridik i pasurisë 18/125/1**, në kundërshtim me nenin 27/dtë ligjitnr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe nr.62/2015. DR ALUIZNI Qarku Diber ka dërguar në adresë të ZVRPP Diber shkresën datë 21.03.2017, për konfirmimin e statusit juridik të pasurisë 18/125/1 për ndërtimin informaldhe nga kjo e fundit nuk është kthyer përgjigje, ndërsa ka pajisur poseduesin me leje legalizimi.

**b.mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor**, nëse ky ndërtim informal ka zënë hapësirat publike dhe nëse pengon planin rregullues të infrastrukturësytë qytetit.

**c.** Në asnjë dokument të dosjes legalizimit nuk pasqyrohen distancat e ndërtimit informal me kufitarët, sipas akt verifikimit në terren 29.12.2015 dhe skicave fushore, të cilat janë të parregullta(*Trajtuar në faqet 97 -108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**27.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Diber në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi **të fillojë procedurat përshfuqizimin e saj**, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

**Brenda muajit Shtator 2018**

**28. Gjetje:**Në 3 raste u konstatua se nuk është respektuar distanca e objekteve nga rruga nacionale Peshkopi-Tiranë, në legalizimin e ndërtimeve informale brenda dhe jashtë zonave të banuara urbane, në kundërshtim me nenet 27, 28, 33, 35, 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, i ndryshuar me ligjin 50/2014, me nenin 25 pika 2 të VKM nr.153, datë 07.04.2000 “*Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në RSH*”, me VKM nr.280, datë 01.04.2015, konkretisht:

**28/1.** Në dosjen me leje legalizimi datë 7.12.2015, pasuria 234, ZK 2592, rezultoi se: ndërtimi informal ndodhet në një distancë 1,6 metër nga rruga nacionale Peshkopi-Tiranë me pak se përcaktimet ligjore prej 10 metër (*kategoria C në zona banuara*),në mos respektim të distancës të ndërtimit informal nga rruga nacionale, sipas genplanit 13.11.2014, fotot, harta dixhitale etj.

**28/2.** Në dosjen me leje legalizimi datë 04.12.2015,pasuria 1/232 ZK 2161, rezultoi se: sipas gen planit nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga nacionale Peshkopi-Tiranë, pasi ndodhet 1,45 dhe 2,65 metër larg saj, në vend që të jetë jo me pak se 5 m në zonat informale brenda zonave të banuara. Objekti i legalizuar nuk ka gjurmë dokumentare se ndërtimi i tij është përfunduar para afatit ligjor deri më 27.6.2014, në kundërshtim me nenin 2/1 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 të ndryshuar me ligjin 62/2015. Ndërtimi informal 3-kat paraqitet karabina e pa përfunduar, çka le shteg abuzimi në të ardhmen për vazhdimin e ndërtimit mbi objektin. Dokumentacioni paraqet kontradikta të dhënash, pasi procesverbali i konstatimit në terren datë 28.10.2014 pasqyron objektin të kufizuar në 3 anët me rrugë lagje dhe nga njëra ane me një godinë 2-kat private, ndërsa gen plani paraqet kufitarë dhe rrugën Peshkopi-Tiranë, e cila nuk pasqyrohet në procesverbal.

**28/3.**Në dosjen me leje legalizimi datë 08.11.2017, pasuria 127/24, ZK 1591, rezultoi se: Leja e legalizimit është dhënë në mënyrë të paligjshme, pasi ndërtimi informalcënon dhe ka shkëlur distancën e objektit nga rruga nacionale Peshkopi-Tiranë, pasi ndodhet 1,30 dhe 2 metër larg saj,

në vend që të jetë jo me pak se 5 m në zonat informale brenda zonës të banuar. Dokumentacioni paraqet kontradikta të dhënash, pasi procesverbali i konstatimit në terren datë 29.10.2014 pasqyron distancën e objektit nga rruga Peshkopi-Tiranë 5 metër, ndryshe nga gen plani i cili e paraqet 1,30 deri 2 metër larg, saj, ndërsa nuk përcakton distancat me 3 kufitarët tjerë. Theksojmë se 2 shkallët me beton ngjitur me ndërtimin informal 2-kat zbresin dhe zënë hapësirën e rrugës nacionale (*Trajtuar në faqet 85 -105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**28/1/2/3. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasinuk kanë respektuar distancat nga rruga nacionale.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**29. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi datë 13.01.2017, pasuria 5/523, ZK 1326, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 15,6 m2, me sipërfaqe ndërtimi 9,6 m2 për banim,rezultoi:

- **Leja e legalizimit është dhënë në mënyrë të paligjshme**, pasishtesa1-kat për banim ngjitur pallatin parafabrikat 5-kat Burrel **ka zënë hapësirën publike**, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" i ndryshuar me ligjin 50/2014, dhe me nenin 62 të rregullores së urbanistikës të ligjit urbanistikës nr.8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar me ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 "*Për planifikimin e territorit*".

- DR ALUIZNI-t Dibër në vitin 2010 nuk e ka legalizuar shtesën, megjithëse kanë përfunduar procedurat e legalizimit, pasi ndërtimi informal është kualifikuar me datë 13.06.2009, VKM nr.247 datë 13.04.2010, akt konstatimi në terren date 20.05.2009 etj. Po kështu DR ALUIZNI Dibër në vitin 2014 nuk e ka legalizuar këtë shtesë, pavarësisht se e ka kualifikuar përsëri sipas vendimit datë 14.11.2014.Nuk shpjegohet arsyeja e legalizimit në vitin 2017pas 11 vjetëve sipas vet deklarimit datë 13.11.2006, në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- **Është rritur sipërfaqja e ndërtimit 15,6m2 nga 9,6m që duhej** si dhe nuk është zgjidhur marrëdhënia me truallin. Mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor, për shtesën e ndërtimit informal, sepse ka zënë hapësirën publike dhe është objekt i INUK sot IMKT.

-**Mungon dokumentacioni tekniko-ligjor, konkretisht certifikata e përbërjes familjare**, në kundërshtim me nenin 27/c, d dhe nenin 28 "dhënia e lejes legalizimit" të ligjitnr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" ndryshuar me ligjin 50/2014, dhenr.62/2015(*Trajtuar në faqet 100 -117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**29.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e saj, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi ndodhet mbi hapësirën publike dhe është object i INUK sot IMKT.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**30. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi 01.02.2017,pasuria 25/96, ZK 2932, rezultoi:  
**a. shtesa ndërtimi informal ka cënuar hapësirën publike (trotuarin e këmbësorëve)**, pasi është futur në trotuarë duke ngushtuar distancën nga rruga nacionale prej 1,2 metër nga 5 që duhej, sipas gen planit dhe fotove në terren. **Ndërtimi informal bashkë me ndërtimet tjera në krah të tij kanë deformuar dhe ngushtuar trotuarin e këmbësorëve ku zhvillohet pazari, pasi shkallët e hyrjes në objekt zënë trotuarin**, çka ka detyruar lëvizjen e këmbësorëve në rrugën



nacionale. Mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor, pasi kjo shtesë ndodhet në hapësirën publike dhe pengon planin rregullues të infrastrukturës rrugore të qytetit, Veprime në kundërshtim me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës, me nenin 31/1/a, 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar ligjin nr.50/2014, me kap II/a të VKM nr.280, datë 01.04.2015, me VKM 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores zbatimit të KRR në RSH” neni 25, pika 2 (Trajtuar në faqet 89 - 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**30.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me pushtetin vendor (IMKT) të detyrojë subjektin, **për lirimin e trotuarit duke prishur shkallët në anën e rrugës nacionale** ngjitur me shtesën e ndërtimit të legalizuar, duke e pasqyruar në procesverbal, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për objektin e pajisur me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e saj, pasi është dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**31. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi 27.08.2017, pasuria 25/80, ZK 2932, rezultoi: **Legalizimi datë 27.08.2017 për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 90m2 është i paligjshëm**, pasi subjekti ka përfituar tepër sipërfaqen 55 m2 ( $90-35=55$ ), sepse ai disponon sipërfaqe totale ndërtimi 35 m2, ku 20 m2 i ka të njohura me vërtetim pronësie dhe 15 m2 i ka shtesë ndërtimi informal. Theksojmë se poseduesi nuk disponon dokument për marrëdhënien me truallin, për pjesën e sipërfaqes 55 m2. Madje, legalizimi i pjesës së parcelës ndërtimore me sipërfaqe 55 m2, bie ndesh edhe me deklaratën noteriale datë 29.9.2017 të subjektit, Nuk disponohet asnjë dokument që kërkohet sipërfaqja 90 m2 parcelë ndërtimore (vetdeklarim, planimetria, VKM s,ka, deklarata noteriale, dokumenti i trashgimisë), por disponohet vetëm genplani datë 24.07.2017, i cili në kundërshtim statusin juridik të pasurisë (*shkresa e ZVRPP nr.1357/1 datë 27.06.2017*) ka rritur artificialisht sipërfaqen e parcelës ndërtimore për 55 m2. Subjekti, mbi godinën ekzistuese 1-kat, lokal me sipërfaqe 20 m2, ka ndërtuar godinën e re 1-kat me sipërfaqe totale ndërtimi 35 m2, duke prishur të parën sipas deklaratës noteriale datë 29.09.2017.

Sipas procesverbalit konstatimit në terren datë 28.10.2016 përcaktohet sipërfaqja totale e ndërtimit 35 m2 për aktivitetet, ndërsa sipërfaqja për parcelën ndërtimore nuk është përcaktuar (*Trajtuar në faqet 98 -120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**31.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me ZVRPP Dibër të korrigjojë lejen e legalizimit, **për kalimin shtet të sipërfaqes të parcelës ndërtimore prej 55 m2**, përfituar tepër dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

**Brenda muajit Tetor 2018**

**32. Gjetje:** Në auditimin e dosjes me leje legalizimi 17.07.2017, pasuria 32/132, ZK 2932, rezultoi:

**-mungon statusi juridik i pasurisë 32/132**, në kundërshtim me nenin 27/dtë ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar me ligjin 50/2014, dhenr.62/2015. Kështu nuk administrohet dokumentacion për pronësinë e parcelës ndërtimore për pasurinë 32/132, pasi shkresa 1738/1 datë 3.7.2017 flet për pasuritë 32/131 dhe 32/127 dhe jo për 32/132.

**- ndërtimi informal nuk plotëson kushtet për legalizim, pasi paraqitet i pa përfunduar**, sepse nuk është plotësuar karabinaja madje mbi soletë ka hekura në vazhdim të ndërtimit katit në të ardhmen, sipas fotove të terrenit, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” i ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014,

- ALUIZNI nuk dispononte në dosje dokumentacion që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje**, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 10 dhe neni 45/ pika 1.

-**Proces verbal i verifikimit** në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje datë 20.5.2017 pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë **por pa përcaktuar largësitë bazës së objektit nga kufijtë e parcelës**. Skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij, largësitë nga objekti te kufiri i pronës, largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve (*Trajtuar në faqet 87 - 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**32.1. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, që për ndërtimin informal “*Godine për aktivitet 1-kat*”, lagjia TEG, Lixha Peshkopi, pasuria 32/132, ZK 2932, të pajisur me leje legalizimi, të fillojë procedurat **për shfuqizimin** e lejes të legalizimit të dhënë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**33. Gjetje:**Në **8 raste** u konstatua mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor në legalizimin e ndërtimeve informale, **si dhe mos plotësim të kushteve për legalizim, pasi ndërtimet informale paraqiten të pa përfunduara**, në kundërshtim me nenet 3 shkronja “a”, 27, 28 dhe 33 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar me ligjin 50/2014, konkretisht:

**33/1.** në dosjen me leje legalizimi datë 19.12.2016, pasuria 1/343/1,ZK 2161, rezultoi se **mungon ortofoto dixhitale që pasqyron kohën e ndërtimit** (para afatit ligjor korrik 2014), për pjesën e shtesës pa leje të legalizuar në 2016, pasi disponon ortofoto dixhitale datë 14.04.2007.

**33/2.** në dosjen me leje legalizimidatë 08.01.2015, pasuria 2/335,ZK 1326, rezultoi se **nuk ka gjurmë dokumentare se ndërtimi është përfunduar para afatit ligjor** korrik 2014, pasi mungon printimi i ortofotos dixhitale, ndryshe nga pasuria 1/343/1, ZK 2161 Klos për të cilën disponohet, pra **janë aplikuar dy standarde**. Mungojnë deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë.

**33/3.** në dosjen me leje legalizimi datë 29.04.2015, pasuria 2/332, ZK 1326, rezultoi se: **mungojnë deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë**, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.50/2014, nenit 62 të rregullores së urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405 17.9.1998 i ndryshuar, të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Skicat nuk i pasqyrojnë distancat me kufitarët, ndërsa procesi verbal i konstatimit datë 4.11.2009 pasqyron disa distanca 0,5 metër nga parcelat kufitare, ndërsa nuk pasqyron distancat nga kufitarët, pasi objekti përveç parcelave dhe objektit ekzistues kufizohet edhe me godina tjera kufitarësh, çka nuk është pasqyruar nga inspektorët e terrenit.

**33/4.** në dosjen me leje legalizimi datë 03.06.2016, pasuria 5/324/1, ZK 2932, rezultoi se: mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor, mungon pamja vizuale e objektit me kufitarët, nuk ka gjurmë dokumentare se ndërtimi është përfunduar para afatit ligjor deri më 27.6.2014, mungon marrëveshja noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji,

**33/5.** në dosjen me leje legalizimi datë 22.04.2016, pasuria 5/88/1, ZK 2932, rezultoi se: leja e legalizimit është dhënë në kushtet e mungesës të gjurmëve dokumentare se ndërtimi është përfunduar para afatit ligjor korrik 2014. Dokumentacioni tekniko-ligjor është fotokopje, fotografimi i objektit nuk është i qartë, mungojnë deklaratat e kufitarëve, pasi objekti ekzistues është shtuar anash dhe lartë, mungon statusi juridik i pasurisë 5/89.

**33/6.** në dosjen me leje legalizimi datë 9.08.2016, pasuria 3/141/1, ZK 1326, rezultoi se: **ndërtimi informal nuk plotëson kushtet për legalizim, pasi paraqitet i papërfunduar**, sepse nuk është plotësuar karabinaja, madje sipas fotove të terrenit mbi soletë ka hekura ku në të ardhmen mundësohet ndërtimi i kateve tjera, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” i ligjit nr.9482, datë

03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar me ligjin 50/2014,

**33/7.** në dosjen me leje legalizimi datë 15.03.2016, pasuria 6/336, ZK 1326, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 13,3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 13,3 m<sup>2</sup> për banim, rezultoi se: **Mungon pamja vizuale e objektit me kufitarët dhe marrëveshja noteriale për pjesët takuese**, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, pasi apartamenti ekzistues 59,7 m<sup>2</sup> është pronë e 3 pjesëtarëve të familjes, sipas certifikatës pronësisë datë 30.04.2003, ndërsa leja e legalizimit është vetëm në emrin e 1 pjesëtari të familjes. **Mungon certifikata e përbërjes familjare**, në kundërshtim me nenin 27 dhe 28, pika c e ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar,

**33/8.** Në dosjen me leje legalizimi datë 21.03.2017, pasuria 16/43/1, ZK 2932, rezultoi se: **mungon statusi juridik i pasurisë 16/43/1**, në kundërshtim me nenin 27/dtë ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ndryshuar me ligjin 50/2014, dhenr.62/2015. Nuk administrohet dokumentacion për pronësinë e parcelës ndërtimore për pasurinë 16/43/1. Shkresa e ZVRPP nr.39/1, datë 17.01.2017 citon për pasuritë 16/43/1 se nuk ka KPP të hapur, kjo shkresë nuk është origjinale dhe e pa noterizuar. **Mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor** nëse ndërtimi informal pengon planin rregullues të infrastrukturës (Trajtuar në faqet 85 - 119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**33./1/2/3/4/5/6/7/8. Rekomandimi:** DR ALUIZNI-t Qarku Dibër të marrë masa që:

- të plotësojë dosjet me dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar sipas trajtimit të mësipërm,
- të verifikojë objektet në terren nëse kanë bërë ndryshime nga legalizimi i tyre, në të kundërtën ti bëjë objekt të ligjit nr.9780, datë 6.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me IMKT.

**Brenda muajit Tetor 2018**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në nin 15/b të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **18 raste detyrime nga tjetërsimi i pronës shtetërore dhe në 43 raste** dhënë parcela mbi trefishin e bazës së ndërtimit per siperfaqen 3899 m<sup>2</sup> në vlerë 51,334,423 lekë; në 7 raste mos shlyerje te penaliteteve ne vlerë 1,791,210 lekë, në 6 raste është dhënë leja e legalizimit duke mbivendosur objektin e legalizuar në pasurinë të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si objekte shtetërore, duke i shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën prej **22,873,090 lekë dhe** në një rast nuk ka llogaritur dhe nuk ka paguar parcelën ndërtimore në **vlerën 133,325 lekë**, si më poshtë:

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI DHE TË ARDHURA TË MUNGUARA**

Mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike**

(Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **18 raste me vlerë 51,334,423**, në 43 raste dhene parcela mbi *trefshit të bazës së ndërtimit per sipërfaqen 3899 m<sup>2</sup>*, në **7 raste mos shlyerje te penaliteteve ne vlerë 1,791,210 lekë**, në 6 raste, është dhënë leja e legalizimit duke mbivendosur objektin e legalizuar në pasurinë të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si objekte shtetërore, duke i shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën prej **22,873,090 lekë** në një rast nuk ka llogaritur dhe nuk ka paguar parcelën ndërtimore në vlerën 133,325 lekë, si më poshtë:

## **B.1. DËM EKONOMIK:**

**1. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër në 18 raste, në Zonën Kadastralnr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.1326, Bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, Bashkia Peshkopi, nr.8612, Bashkia Bulqizë, për sipërfaqen e përgjithshme ndërtimore 1190.18 m<sup>2</sup>, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986004, dt. 16.07.2015; nr.986320, dt. 12.05.2016, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr.986409, dt.27.07.2016, nr.986433, dt.16.08.2016, nr.985935, dt.17.05.15; nr.986048, dt.12.05.15, nr.986100, dt. 23.11.15, nr.67178, dt.11.07.13, nr.986502, dt. 20.09.2016, nr.987070, dt.08.01.2018, nr.985017, dt.28.10.17, nr.65359, datë 27.12.2012, nr.34466, dt. 24.09.12, nr.986509, dt. 06.10.16, nr.986456, dt.02.09.16, nr.986149, dt. 12.02.16, **ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statutet juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.**

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezulton të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore sidhe të njësisë apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUIZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, prej 1334.08, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB, 39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016, llogaritet në 51,334,423 lekë.

***Vlera prej 51,334,423 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuara, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin epërbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, ‘‘Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë’’, i ndryshuar neni 172 (Trajtuar në faqet 65 -95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër**, të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **51,334,423 lekë** e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore për 19 rastet e objekteve pronë ‘‘Shtet’’ dhe ‘‘Pronar i pavërtetuar, në bashkëpunim me institucionet shtetërore pronare dhe administruese të objekteve të legalizuara në kundërshtim me ligjin,

**Brenda muajit Tetor 2018**

**2. Gjetje:DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër, në 34 raste,**ka lëshuar lejet e legalizimit: Nr.986008, dt.16.07.16; Nr.986408, dt.27.07.16; Nr.986433, dt.16.08.16; Nr.986935, dt.17.05.15; Nr.986939, dt.17.05.15; Nr.986048, dt.13.08.15; Nr.986100, dt.23.11.15,nr.95934,datë 06.05.2015,nr.95933 ,dt.10.05.2015 , nr.9858891 ,dt. 01.03.2015, nr.9888338 dt.03.06.2016, nr.986066 dt.28.09.2015, nr.995043 dt.30.06.2015, nr.986102, dt.23.11.2015, nr.995945, dt. 20.06.2015, nr.995944 dt.30.06.2015, si dhe në **18 raste të tjera**, leje për godina banimi, në të cilat u konstatua se sipërfaqja e parcelës ndërtimore tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet ‘‘Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>’.’.

Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por që gjithsesi i ka kaluar në pronësi me anë të lejes së legalizimit. Sipërfaqja që është dhënë tepër mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a dhe pikën 1/c .

**Sipërfaqja mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit është 3899 m<sup>2</sup>.**

Në zbatim të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’, i ndryshuar, neni 17, pika 1/c, për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, atëherë diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr.514, datë 30.07.2014 ‘‘Për miratimin e vlerës së pronës përsecilin qark të Republikës sëShqipërisë’’, të ndryshuar me VKM nr.89, datë 03.02.2016.

**Vlera prej 6,538,086 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë ‘‘Shtet’’ për godina banimi, të shitur subjekteve informalë, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit(Trajtuar në faqet 75 -98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**2.1.Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Dibër të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **6,538,086 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë ‘‘Shtet’’ për godina banimi, të shitur subjekteve informalë, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**3. Gjetje: -Në 7 raste**, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe prej 5% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe shërbimi sipas nenit 43, të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ‘‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’’. **Mos shlyerja e penaliteteve nga subjektet ndërtuese, për sipërfaqen shtesë të ndërtuar është në vlerën 1,791,210 lekë, që përbën dëm**

**ekonomik për buxhetin e shtetit**(Trajtuar më hollësisht në faqet 75 deri 98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën totale prej 1,791,210 lekë, nga këto; subjekti V.K vlerën 622,456 lekë, subjekti B.K. vlerën 117,458 lekë, subjekti E.V. vlerën 215,534 lekë, subjekti D.K. vlerën 258,872 lekë, subjekti Sh.Ç. vlerën 68,945 lekë, subjekti P.B. vlerën 343,795 lekë dhe subjekti L.Sh. vlerën 164,150 lekë.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**4. Gjetje:** Në **6 raste**, është dhënë leja e legalizimit duke mbivendosur objektin e legalizuar në pasurinë të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si objekte shtetërore, duke i shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën prej **22,873,090 lekë** (prishje e objekteve shtetërore dhe legalizim mbi to të objekteve private pa u zhdëmtuar vlera e tyre, llogaritur me çmimin e Entit Kombëtar të Banesave). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016 dhe Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar (Trajtuar në faqet 75 -98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër për rastet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas lejeve të legalizimit me nr.986003, datë 16.07.2015, nr.986506, datë 03.10.2016, nr.986931, datë 26.07.2017, nr.986638, datë 21.12.2016, nr.9878916, datë 30.04.2018 dhe nr.986877, datë 04.07.2016, të marrë masa që në bashkëpunim me organet hetimore të identifikojnë personat përgjegjës për prishjen e objekteve shtetërore dhe në rrugë ligjore (duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit) të kërkojnë arkëtimin e vlerës prej **22,873,090 lekë të konsideruar si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit si pasojë e prishjes së objekteve shtetërore dhe legalizim mbi to të objekteve private.**

**Brenda muajit Tetor 2018**

**5. Gjetje:** Në **1 rast**, nga verifikimi i formularëve të pagesës dhe mandatpagesës për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore rezulton se janë paguar në total vetëm 74,995 lekë për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore prej 112m<sup>2</sup>. Sipas VKM nr.514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark në Republikën e Shqipërisë", çmimi për 1m<sup>2</sup> truall në Qytetin e Klosit, ZK 2161, është 1860 lekë. Duke qenë se në zbatim të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17/2, çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik është ai i përcaktuar në bazë të vlerës së pronës, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, atëherë 112m<sup>2</sup> X 1860 lekë/m<sup>2</sup> - 74,995 lekë = **133,325 lekë**, si detyrim i pallogaritur dhe i papaguar, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit (Trajtuar në faqet 75 - 98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të pallogaritura dhe të papaguara për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me leje legalizimi nr.986003, datë 16.07.2015, në vlerën **133,325 lekë nga subjekti B.D.**

**Brenda muajit Tetor 2018**

## **B.2. DËM EKONOMIK(TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër sipas pasqyrave të paraqitura, për 527 objekte, ka lëshuar leje legalizimi për objekte, pronarët e të cilave kanë përfutur një sipërfaqe

totale **130,815.9 m<sup>2</sup>**, ndërkohë që duhej të likujdonin për parcelën ndërtimore vlerën **261,631,800 lekë**(130,815.9 m<sup>2</sup> x 2000 lekë për m<sup>2</sup>), ndarë afërsisht 50% me lekë dhe 50% bono privatizimi(lekë + bono privatizimi) ose **130,815,900 lekë dhe 130,815,900 bono privatizimi**, të cilat ngelen të pa arkëtuara(**261,631,800 lekë+bono privatizimi**). Kjo ka ardhur në mungesë të VKM-ve, si dhe mos përpunueshmëri me kërkesat e pikës 5 e nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” **me zgjatje të procedurave dhe mos paraqitje të qytetarëve për të likujduar detyrimin e parcelave ndërtimore, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit** (Trajtuar në faqet 30 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, të marrë masa për **491 dosje** dhe të nisë menjëherë shkresat për deklarimin e VKM-ve, me qëllim përshpejtimin në daljen e VKM dhe të likuidimit nga subjektet për ndërtimet informale të vleftës së parcelave ndërtimore prej **130,815,900 lekë dhe 130,815,900 bono privatizimi dhe krijuar impact social pozitiv tek banorët e këtij Qarku.**

**Brenda muajit Shtator 2018**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996, ligjin nr.9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr.136/2015, ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t dhe Drejtorit Rajonal të ALUIZNI-t Dibër**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri “**Largim nga puna**”, për këta punonjës:

**I. “Largim nga puna”,** për këta punonjës

**I. Sh.T. me detyrë Drejtor, sepse:**

**Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Dibër**, lidhur me taksëne ndikimit nëinfrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk ështëkërkuar vërtetimi, për likujdimin etaksës të ndikimitnë infrastrukture në vlerën **26, 517,252lekë, nuk kabashkëpunim** në nivelin e duhur me Drejtoritë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore me Bashkinë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos, në kundërshtim me nenin 27,pika (ç) e ligjit 9482,datë 03.04.2006,i ndryshuar

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore, **331 dosje** duke shkelur afatet ligjore, në kundërshtim menenin 28, të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- Nga 527 objekte, për **491 objekte**, DR Qarku Dibër, **nuk ka nisur shkresat për daljen e VKM-ve** dhe në dosjet e audituara nuk gjendet as një lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë.

-**Në 3 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012,datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 4 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik)**. Ndërtimet pa leje nuk duhet të

legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

**-Në 2 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i liqenit të Ulzës,** ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më të vogël se distanca e lejuar prej 100 metrash,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 1 rast,** nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

**-Në 2 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga liqeni i Luzës,** ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 2 raste,** nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose “PPV”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet *“Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”*

**-Në 2 raste,** ka miratuar leje legalizimi për objektet pa u nga subjektet penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuesenë vlerën 2% të çmimit minimal fiskal për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe në vlerën 5% të çmimit minimal fiskal për veprimtari socio-ekonomike sipas nenit 43 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Mos shlyerja e penaliteteve për sipërfaqet shtesë të ndërtuara nga subjektet **ka shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 966,251 lekë;**

-Për shkelje dhe konflikt interesi në dhënien e lejes legalizimit datë 08.10.2017, për ndërtimin informal “ *godine social-ekonomike 2-kat*”, Maqellarë, pasuria 119/1/1, ZK 2592, pasi distanca e objektit nga rruga nacionale pasqyrohet 1,25 metër nga 10 metër që duhej, si dhe leja është nënshkruar nga drejtori për vëllain e tij,



-Për shkelje në dhënien e lejes legalizimi datë 14.9.2017, ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik, pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, pasi ndërtimi informalprek dhe çënon zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore, të unazës së qytetit, sipas shkresës të bashkisë nr.4068/1, datë 7.9.2017. Për pasojë nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga e unazës të qytetit, pasi ndodhet 2,5 metër larg saj, në vend që të jetë jo me pak se 5 m, në kundërshtim me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, me nenin 35 dhe 39 të ligjitnr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar ligjin nr.50/2014 dhe me VKM nr.756 datë10.2016 pika 2 /i/gj.

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimi datë 13.12.2017, për ndërtimin informal “*shtesë 1-kat ne objektin ekzistues 1-kat për aktivitet*” Maqellare, pasuria 60/27/1, ZK 1384, pasi shtesa është ngjitur objektit ekzistues pikë karburanti dhe paraqet rrezik zjarri,në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 të ndryshuar, me VKM nr.756 datë...10.2016 pika 2 /gj dhe 3,

-për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 2 raste, pasi shkallëtcenojnë hapësirat publike, përkatësisht: pasuria 11/158, ZK 2932 dhe 127/24, ZK 1591, në kundërshtim menenet 27, 31,39, 41, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, me VKM 280, datë 1.4.2015.

- për shkelje në legalizimin e pasurisë 127/24, ZK 1591, pasi nuk janë respektuar distancat nga rruga nacionale,në kundërshtim me nenet 27, 28, 33, 35, 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014, me nenin 25 pika 2 të VKM nr.153, date 07.04.2000 “*Për miratimin e rregullores zbatimit të KRR në RSH*”, me VKM nr.280, datë 1.4.2015,

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimit 27.08.2017, për pasurinë nr.25/80, ZK 2932,pasi subjekti ka përfituruar 90 m2 parcelë ndërtimore nga 35 që i takon ose tepër 55 m2 . Poseduesi nuk disponon dokument për marrëdhënien me truallin për pjesën e sipërfaqes 55 m2, madje legalizimi isipërfaqes 55 m2bie ndesh edhe medeklaratës noteriale datë 29.9.2017 të subjektit.

-**Në 2 raste**, në Zonën Kadastrale nr.2161, nr.2164, bashkia Klos, nr.1326, Bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, bashkia Peshkopi, nr.8612, bashkia Bulqizë, ka lëshuarlejet e legalizimit: Nr.987070, dt. 08.01.2018, 985017, dt. 28.10.17,ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhestatusetjuridikëtë pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janëpronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklaratat noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”dhe nuk rezulton të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore sidhe të njësisive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matitsipas EKB çmimi 39,767 lekë/m<sup>2</sup> sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016 llogaritet në 6,396,124 lekë.

***Vlera prej 6,396,124 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të ZQRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172.

**-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale nr.2161**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale nr.2164**, ka lëshuar lejen e legalizimit: nr.987011, dt. 12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, përsipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhen në afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat, është më e vogël se 100 m, distancë prej 40 m, brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim objektet me sipërfaqen “Truall”.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 14 raste**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.nr.987070, datë 08.01.2018; nr.985017, dt. 28.10.17; nr.986917, dt. 09.07.17; nr.986901, dt. 25.06.17, nr.986932, dt. 26.07.17; nr.987836, dt. 28.02.18; nr.986838, dt. 16.05.17; nr.986998, dt. 22.09.17; nr.986895, dt. 22.06.17; nr.986936, dt. 27.07.17; nr.986926, dt. 25.07.17; nr.987010, dt. 13.10.17; nr.987011, dt. 12.10.17; nr.986908, dt. 15.07.17; në kushtet e mungesës së inventarëve përkatës të këtyre dosjeve, sipas dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, kalëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), në kundërshtim me urdhrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 1 rast**, ka lëshuar lejen e legalizimit nr.986895, dt. 22.06.17, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr.258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”.

## **2. F.R. specialist legalizimi, sepse:**

- Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë në vlerën **26, 517,252 lekë**, nuk ka bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, me bashkinë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos, në kundërshtim me nenin 27, pika (ç) e ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- Nga 527 objekte, për **491 objekte**, DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër, **nuk ka nisur shkresat për daljen e VKM-ve** dhe në dosjet e audituara nuk gjendet as një lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë.

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore, **331 dosje**, duke shkelur afatet ligjore në kundërshtim me nenin 28 të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

**-Në 6 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 11 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik)**. Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

**-Në 3 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

**-Në 2 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 1 rast**, nga verifikimi i hartës dixhitale Google Earth, rezulton se ka legalizuar një objekt i cili nuk ishte ndërtuar deri në datën 27.06.2014, pra nuk ekzistonte në atë kohë, e për pasojë duhet të ishte përjashtuar nga legalizimi sepse sipas fushës së zbatimit të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, të përcaktuar në nenin 2 “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”. Pra, **ndërtesa e legalizuar nuk është objekt i ligjit**, për pasojë është legalizuar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

**-Në 2 raste**, ka dhënë leje legalizimi për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup> dhe 250m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë **është dhënë në tejkallim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër, duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

**-Në disa raste, nuk ka paraqitur me vërtetësi nga ana grafike distancat e objekteve të legalizuara nga lumi Mat, rrugët e kategorisë C, liqeni i Ulzës si edhe nuk ka pasqyruar grafikisht vendodhjen e objekteve në territorin e Zonave të Mbrojtura duke shmangur qëllimisht përjashtimin e këtyre objekteve nga legalizimi dhe duke mundësuar kështu legalizimin në kundërshtim me ligjin të këtyre objekteve.**

**-Në 1 rast**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet “*Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”*

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi.

**-Në 1 rast** ka pasqyruar të dhënat e verifikimit në terren sikur objekti të ishte godinë banimi dhe për pasojë leja e legalizimit është dhënë për godinë banimi ndërkohë që faktikisht objekti është magazinë;

-për shkelje në legalizimin datë 06.02.2016 për pasurinë 22/104, ZK 2932, pasi ndërtimi informallokal 1-kat është ndërtuar në rrëpirën e përroit dhe nuk ka themele, por është vendosur mbi trarë hekuri me rrezik shembje, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar,

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 31.01.2017, për ndërtimin informal “godinë e kombinuar 3-kat”, Bulqizë, pasuria 2/122/1, ZK 8612, pasi ndërtimi informal 3-kat nuk plotëson kushtet për legalizim, sepse paraqitet i pa përfunduar, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” i ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014,

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 27.08.2017, për ndërtimin informal “godinë shërbimi 1-kat”, Bulqizë, pasuria 1862, ZK 3694, pasika përdorur 2 standarte lidhur me miratimin e parcelës ndërtimore, sepse nuk ka argumentuar shtesën dhe pakësimin e saj. Kështu ka rritur sipërfaqen e parcelës ndërtimore në masën 836 m<sup>2</sup> nga 646 m<sup>2</sup> që duhej, sipas KPP të ZVRPP, vol 8 faqe 16, ndryshe nga pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 48 m<sup>2</sup> me sipërfaqe ndërtimi 48 m<sup>2</sup>, që nuk është rritur.

-për aplikimin me 2 standarte lidhur me hartimin e genplaneve, pasi për pasurinë nr.1862 ku është respektuar distanca 46 metër nga rruga nacionale është pasqyruar në genplan, ndryshenga pasuria 1/436/1ku nuk është respektuar distanca nga rruga nacionale nuk është pasqyruar në genplan. Gjithashtu për këtë të fundit nuk pasqyrohen saktë kufitarët, madje rrugën nacionale e ka pasqyruar rrugë lagje, për efekt të shmangies të mos respektimit të distancës, sipas proces verbalit konstatimit datë 28.10.2014.

-për mos përcaktimin e distancave të objektit nga 3 kufitarët dhe me rrugën nacionale, sipas procesverbalit verifikimit në terren datë 13.11.2016, për pasurinë 119/1/1, ZK 2592.

-për aplikimin me 2 standarde, lidhur me hartimin e procesverbalit të konstatimit në terren datë 26.05.2017 për pasurinë nr.1862, pasi është hartuar nga 1 person si hartograf dhe specialist i legalizimit, në vend të 2 specialisteve, siç është vepruar në rastet tjera. Ky fenomen është konstatuar dhe në rastet e tjera.

**-Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim).

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 5 raste, në Zonën Kadastrale nr.2161, nr.2164, bashkia Klos, nr.1326, bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, bashkia Peshkopi, nr.8612, bashkia Bulqizë**, për lejet e legalizimit: nr.986004, dt.16.07.2015, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr.986048, dt.12.05.15, nr.986509, dt.06.10.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhestatuset juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezulton të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore si dhe të njësisë apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUIZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB cmi I është 39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016, llogaritet në 15,874,986 lekë.

***Vlera prej 15,874,986 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin epërbashkët të ZQRPP dhe ALUIZNI-t, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 172.

**Në 3 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, 1326, 2592**, për lejet e legalizimit: 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986119, dt. 10.12.15; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

-Në 2 raste, për lejet e legalizimit: nr.986095, dt. 12.11.15; nr.986474, dt. 07.03.16; në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për sipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhennë afërsi të lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat dhe përroi, është e vogël se 100 m, distancë që luhet në segmentin 26 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 2 e mësipërme.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

### 3. V. Gj. juriste, sepse;

-Në 4 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Në 11 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik). Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin, sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtimet të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe ligjin nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

-Në 2 raste, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

-Në 4 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga liqeni i Luzës, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Në 1 rast, nga verifikimi i hartës dixhitale Google Earth, rezulton se ka legalizuar një objekt i cili nuk ishte ndërtuar deri në datën 27.06.2014, pra nuk ekzistonte në atë kohë, e për pasojë duhet të ishte përjashtuar nga legalizimi sepse sipas fushës së zbatimit të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, të përcaktuar në nenin 2 “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”. Pra, **ndërtesa e legalizuar nuk është objekt i ligjit**, për pasojë është legalizuar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-Në 1 rast, ka dhënë leja e legalizimit për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 250 m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë **është dhënë në tejkalim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër, duke shmangur qëllimisht**

**procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”.** Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

**-Në 5 raste,** nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe prej 5% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe shërbimi sipas nenit 43, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. **Mosshlyerja e penaliteteve nga subjektet ndërtuese, për sipërfaqen shtesë të ndërtuar është në vlerën 1,051,296 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

**-Në 6 raste,** nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose pronë e të tretëve. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje” i ndryshuar, ku citohet *“Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”*

**-Në 1 rast, ka kryer legalizim të objektit pa respektuar distancat nga bregu i përroit,** ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së përroit me pak se 100 metra,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b;

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 31.01.2017, pasuria 2/122/1, ZK 8612, pasi ndërtimi informal 3-kat nuk plotëson kushtet për legalizim, sepse paraqitet i pa përfunduar, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimit datë 14.9.2017, ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik, pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, pasi ndërtimi informal prek dhe cënon zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore, të unazës së qytetit, sipas shkresës të bashkisë nr.4068/1, datë 7.9.2017. Për pasojë nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga e unazës të qytetit, pasi ndodhet 2,5 metër larg saj, në vend që të jetë jo me pak se 5 m, në kundërshtim me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar ligjin nr.50/2014 dhe me VKM nr.756 datë 10.2016 pika 2 /i/gj.

-për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 3 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre (*shkallët*) cenojnë hapësirat dhe sheshet publike, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015.

**-Në 2 raste, në Zonat Kadastrale,** për lejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; nr.986304, dt. 20.04.16, në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në3 raste**, për lejet e legalizimit: nr.986777, dt. 23.03.17;nr.986095, dt. 12.11.15; nr.987011, dt.12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe sipërfaqe ndërtimore të legalizuara, ndodhënë afërsi të lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhet në segmentin 26 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme. Sa më sipërnuk duheshinpranuar për legalizim 7 objektet në sipërfaqen e përgjithshme prej: “Truall” 1763m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 802 m<sup>2</sup>.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 1 rast, në ZK nr.2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384,dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate, me adresë: fshati “Ostren i Madh”, bashkia Bulqizë, Zona Kadastrale nr.2846, nr.pasurie 1691/1, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit,në kushtet, kursipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr.417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr.1755, datë 05.04.2016, “kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr.1691, regjistruar në vol. 8, faqe 182, të ZK 2846, Bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”: 5031 m<sup>2</sup>.

Në këtë rast për nuk lejohet lëshimii lejeve të legalizimit, dhe konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384,dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullimore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, nenet 10 dhe 17.

**-Në 5 raste**, për lejet e legalizimit: nr.986095, dt.12.11.15; nr.986141, dt.26.01.16; nr.986125, dt.21.12.15; nr.986139, dt.26.01.16; nr.986134, dt. 10.01.16; në kushtet e mungesës së deklaratëspersonale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**- Në 2 raste**, përlejet e legalizimit nr.986181, dt. 21.03.16, nr.986895, dt. 22.06.17, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dheDibër, në kundërshtim me VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 42,

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

- UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruetit”, pikat 2 e 3.



-VKM nr.258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

**-Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit,në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdhrrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

## **II. “Vërejtje”**

### **1. Q.P. , sepse:**

**Drejtoria Rajonale e Qarku Dibër**,lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë në vlerën **26, 517,252lekë**, **nuk ka** bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtoritë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me Bashkinë Peshkopi, Bashkia Bulqizë, Bashkia Mat, Bashkia Klos, në kundërshtim me nenin 27,pika (ç) e ligjit 9482,datë 03.04.2006, i ndryshuar

- Nga 527 objekte, për **491 objekte**, DR Qarku Dibër, **nuk ka nisur shkresat për daljen e VKM-vedhe** në dosjet e audituara nuk gjendet as një lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë

- Nuk ka ndjekur procedurat ligjore, **331 dosje** duke shkëlur afatet ligjore, në kundërshtim me nenin 28, të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- **Në 5 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012,datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

- **Në 9 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik)**. Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

- **Në 2 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

- **Në 2 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin Nr.111/2012,datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

- Në 2 raste, ka kryer legalizim të objekteve pa respektuar distancat nga bregu i përroit, ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së përroit më pak se 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Në 6 raste, ka dhënë leje legalizimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej 718.4m<sup>2</sup> në total mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit dhe duke i ndryshuar zërin kadastral nga “Arë” në “Truall”, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a.

-Në 1 rast, në një zonë informale të pa miratuar nga KRRTRSH/KKT ka dhënë leje legalizimi për objektin "Pallat 9 kate" dhe është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore, të regjistruar në ZVRPP në zërin kadastral “Pyll”, duke ndryshuar zërin kadastral nga "Pyll" në "Truall" pa miratimin e autoriteteve përkatëse. Legalizimi i objektit është kryer në zonë “Territore të tjera”, për të cilën nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

-Në 5 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe prej 5% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe shërbimi sipas nenit 43 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. **Mosshlyerja e penaliteteve nga subjektet ndërtuese, për sipërfaqen shtesë të ndërtuar është në vlerën 1,414,880 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Në 6 raste, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose pronë e të tretëve. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet “*Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.*”

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi;

-për dhënien e lejes legalizimit datë 06.02.2016, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

i ndryshuar, për pasurinë 22/104, ZK 2932, pasi ndërtimi informal lokal 1-kat është ndërtuar në rrëpirën e përroit dhe nuk ka themele por qëndron mbi trarë hekuri me rrezik shembje,

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimit datë 13.12.2017, pasuria 60/27/1, ZK 1384, pasi shtesa është ngjitur objektit ekzistues pikë karburanti dhe paraqet rrezik zjarri, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me VKM nr.756 datë 10.2016 pika 2 /gj dhe 3,

-për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 4 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre (*shkallët*) cenojnë hapësirat dhe sheshet publike, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015.

**-Në 9 raste**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986320, dt. 12.05.2016, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr.986409, dt. 27.07.2016, nr.986433, datë 16.08.2016, nr.986502, dt. 20.09.2016, nr.985017, dt. 28.10.17, nr.986509, dt. 06.10.16, nr.986456, dt. 02.09.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statuset juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezultojnë të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administrative vendore apo qendrore, si dhe të njësisve apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNIT Dibrë.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB cmimi 39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016, llogaritet në 23,014,754 lekë.

***Vlera prej 23,014,754 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të ZQRPP dhe ALUZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172.

**-Në 3 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, 1326, 2592**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986304, dt. 20.04.16; 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986509, dt. 06.10.16; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në3 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, Bashkia Klos, nr.3959, nr.1164,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986777, dt. 23.03.17;nr.986474, dt. 07.03.16; nr.987011,dt. 12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për një sipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhë afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i Lumit Mat dhe përroi, është e vogël se 100 m, distancë që luhatet në segmentin 40 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme. Sa më sipërnuk duheshin pranuar për legalizim 3 objektet e sipërpërmendura.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 2raste,**ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986408, dt. 27.07.16; nr.986433, dt. 16.08.16;leje për godina banimi, në të cilat u konstatua se sipërfaqja e parcelës ndërtimore tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>”.

Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por që gjithsesi i ka kaluar në pronësi me anë të lejes së legalizimit. Sipërfaqja që është dhënë tepër mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>” dhe pikën 1/c “Kur për shkak të përmasave ose plan vendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.”

**Sipërfaqja mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit është 62.9 m<sup>2</sup>.**

Në zbatim të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/c, për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, atëherë diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr.514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr.89, datë 03.02.2016.

*Vlera prej 94,799 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë “Shtet” për godina banimi, të shitur subjekteve informale, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.*

**-Në 4 raste,** në Zonat Kadastrale nr.2161, nr.2312, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.986004, datë 18.07.2015; nr.986141, dt. 26.01.16; nr.986125, dt. 21.12.15; nr.986139, dt. 26.01.16; nr.986134, dt. 10.01.16; në kushtet e mungesës së deklaratëspersonale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim

me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

- **Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim).

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

-**Në 2 raste, në zonat kadastrale nr.2161 Klos dhe nr.8612 Bulqizë**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.986181, dt. 21.03.16, nr.986895, dt. 22.06.17, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtësë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr.258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 42,

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

- UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”, pikat 2 e 3.

-VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

## **2. B.Sh., sepse:**

-**Në 6 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 11 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik)**. Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

-**Në 4 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se **ka legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

-**Në 3 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga Liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për

rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 2 raste, ka kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet e përroit**, ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së përroit me pak se 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 1 rast**, në një zonë informale të pa miratuar nga KRRTRSH/KKT **ka dhënë leje legalizimi për objektin "Pallat 9 kate"** dhe është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore, të regjistruar në ZVRPP në zërin kadastral “Pyll”, **duke ndryshuar zërin kadastral nga "Pyll" në "Truall" pa miratimin e autoriteteve përkatëse**. Legalizimi i objektit është kryer në zonë “Territore të tjera”, **për të cilën nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr.589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.**

-**Në 2 raste**, ka dhënë leje legalizimi për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup> dhe 250 m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë **është dhënë në tejkallim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-**Në 5 raste**, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe prej 5% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe shërbimi sipas nenit 43, të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. **Mos shlyerja e penalteteve nga subjektet ndërtuese, për sipërfaqen shtesë të ndërtuar është në vlerën 909,882 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-**Në 5 raste**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose pronë e të tretëve. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet **“Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”**

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për

arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi;

**-Në 13 raste, në Zonën Kadastrale nr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.1326, Bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, Bashkia Peshkopi, nr.8612, Bashkia Bulqizë,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986004,dt. 16.07.2015, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr.986409, dt. 27.07.2016, nr.985935, dt. 17.05.15, nr.986048, dt. 12.05.15, nr.986100, dt. 23.11.15, nr.67178,dt. 11.07.13, nr.986502, dt. 20.09.2016,nr.987070, dt. 08.01.2018, nr.985017, dt. 28.10.17, nr.34466, dt. 24.09.12, nr.986509, dt. 06.10.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statutet juridike të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi dhe Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”dhe nuk rezulton të jenë zbatuarprocedurat përpasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore sidhe të njësisive apo institucioneveshtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Matit sipas EKB cmimi në vlerën **39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016, llogaritet në 44,884,215 lekë.**

**Vlera prej 43,166,281 lekë., e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2 dhe 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në 172.

**-Në 5 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, 1326, 2592,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; nr.986304, dt. 20.04.16; 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986119, dt. 10.12.15; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në5 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.3959, nr.1164,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.67178, dt. 11.07.13; nr.986777, dt. 23.03.17; nr.34466, dt. 24.09.12; nr.986474, dt. 07.03.16; nr.987011,dt. 12.10.17,në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për sipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe sipërfaqe ndërtimore të legalizuar ndodhen në afërsi të lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale,

u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhetet në segmentin 36 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 5 objektet e mësipërme.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 1 rast, në ZK nr.2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate, me adresë: fshati “Ostren i Madh”, bashkia Bulqizë, Zona Kadastrale nr.2846, nr.pasurie 1691/1, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit, në kushtet, kursipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr.417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr.1755, datë 05.04.2016, “kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr.1691, regjistruar në vol. 8, faqe 182, të ZK 2846, bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”: 5031 m<sup>2</sup>.

Në katë rast për nuk lejohet lëshimii lejeve të legalizimit, dhe konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullimore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, nenet 10 dhe 17.

**-Në 6 raste**, në Zonat Kadastrale nr.2161, nr.2312, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.986004, datë 18.07.2015; nr.986141, dt.26.01.16; nr.986125, dt.21.12.15; nr.985954, dt. 30.06.15; nr.986139, dt. 26.01.16; nr.986134, dt. 10.01.16; në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim).

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdhrrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 3 raste, në zonat kadastrale nr.2161 Klos dhe nr.8612 Bulqizë**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.985935, dt. 17.05.15, nr.986048, dt. 12.05.15, nr.986895, dt. 22.06.17, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 42,

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.



- UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, pikat 2 e 3.
- VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara

### **III. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.**

Për13 ish-punonjës, edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** deri në **“Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)”**, përkatësisht për: z.B.G, z.E.M, z.F.M, z.Z.H, z.S.R, z.A.Gj, z.I.R, z.E.Sh, z.R.L, z.T.T, z.E.R dhe z. F.Z.

**- Për z N.K, ish/Drejtor, do të jepej masa disiplinore “ Largim nga puna , I cili aktualisht nuk është në marrëdhënie pune në institucionet e ALUIZNI-t, sepse:**

**-Në 5 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 9 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulëzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik).** Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe ligjin nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

**-Në 3 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

**-Në 1 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 1 rast**, në një zonë informale të pa miratuar nga KRRTRSH/KKT ka dhënë leje legalizimi për objektin **“Pallat 9 kate”** dhe është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore, të regjistruar në ZVRPP në zërin kadastral “Pyll”, **duke ndryshuar zërin kadastral nga “Pyll” në “Truall” pa miratimin e autoriteteve përkatëse.** Legalizimi i objektit është kryer në zonën “Territore të tjera”, për të cilën nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 **“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për**

propozimin e miratimit të zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

**-Në 1 rast**, ka legalizuar shtesën anësore 1-kat, me sipërfaqe 29.4m<sup>2</sup>, në ZK 1326, pasuria nr.4/431, e cila sipas fotove të deklaruesit paraqitet **karabina pa mbulesë me çati apo soletë**. Leja e legalizimit është miratuar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

**-Në 2 raste**, ka dhënë leje legalizimi për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup> dhe 250m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë është **dhënë në tejkallim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër, duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

**-Në 4 raste**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose “PPV”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet **“Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”**

**-Në 7 raste**, ka miratuar leje legalizimi për objektet pa u nga subjektet penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën 2% tëçmimit minimal fiskal për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe në vlerën 5% të çmimit minimal fiskal për veprimtari socio-ekonomike sipas nenit 43 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Mos shlyerja e penaliteteve për sipërfaqet shtesë të ndërtuara nga subjektet **ka shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,302,079 lekë**.

**-Në 12 raste**, ka dhënë leje legalizimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej 1461.9m<sup>2</sup> në total mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit dhe duke i ndryshuar zërin kadastral nga “Arë” në “Truall”, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a.

**-Në 2 raste**, ka kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet e përroit, ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së përroit me pak se 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi;

-Për dhënien e lejes legalizimit datë 06.02.2016, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, për pasurinë 22/104, ZK 2932, pasi ndërtimi informal lokal 1-kat është ndërtuar në rrëpirën e përroit dhe nuk ka themele dhe qëndron mbi trarë hekuri me rrezik shembje,

-Për legalizimin e ndërtimeve informate në 8 raste, me mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe mos plotësim të kushteve për legalizim, pasi ndërtimet informate paraqiten të pa përfunduara, në kundërshtim me nenet 3, 27, 28 dhe 33 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014, konkretisht: për pasuritë nr. 1/343/1, ZK 2161, nr. 2/332, ZK 1326, nr.5/324/1, ZK 2932, nr.5/88/1, ZK 2932, nr.3/141/1, ZK 1326, nr.6/336, ZK 1326 dhe nr. 16/43/1, ZK 2932.

-Për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 5 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre (*shkallëti*) cenojnë hapësirat dhe sheshet publike, përkatësisht: pasuria 755/2, ZK 2592, nr. 1/436/1, ZK 2161, nr.14/26, ZK 2932, nr.13/100, ZK 2932, nr.5/523, ZK 1326, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015.

-Për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale brenda dhe jashtë zonave të banuara urbane, në 2 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre nuk kanë respektuar distancat nga rruga nacionale, në kundërshtim me nenet 27, 28, 33, 35, 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar me ligjin 50/2014, me nenin 25 pika 2 të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në RSH”, me VKM nr.280, datë 1.4.2015, konkretisht: pasuria 234, ZK 2592 dhe nr.1/232, ZK 2161.

**-Në 13 raste, në Zonën Kadastralenr. 2161, nr. 2164, bashkia Klos, nr. 1326, bashkia Mat, nr. 2592, nr. 2932, bashkia Peshkopi, nr. 8612, bashkia Bulqizë,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986004, dt.16.07.2015, nr. 986320, dt.12.05.2016, nr. 986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr. 986409, dt. 27.07.2016, nr. 986433, datë 16.08.2016, nr.985935, dt.17.05.15, nr.986048, dt.12.05.15, nr.986100, dt.23.11.15, nr.986502, dt.20.09.2016, nr. 986509, dt. 06.10.16, nr. 986456, dt. 02.09.16, nr. 986149, dt. 12.02.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statuset juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezultojnë të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore si dhe të njësisive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet se ndërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB, 39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, llogaritet në 40,309,421 lekë.

***Vlera prej 38,591,487 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore prone “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUIZNIT, nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172.  
**-Në 4 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, 1326, 2592,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr. 986304, dt.20.04.16; 986185, dt.21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986509, dt.06.10.16; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C,në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në 4 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, nr. 2164, Bashkia Klos, nr. 3959, nr. 1164,** ka lëshuar lejet e legalizimit: nr. 986777, dt. 23.03.17; nr.986095, dt.12.11.15; nr. 985936, dt.17.05.15; nr.986474, dt.07.03.16 në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për sipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhen në afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhetet në segmentin 36 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e pa parashkrueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 4 objektet në sipërfaqen “Truall”.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 7 raste, në Zonat Kadastrale nr. 1137, 1326, 2161, Bashkia Klos,**ka lëshuar lejet e legalizimit: Nr. 986008, dt. 16.07.16; Nr. 986408, dt.27.07.16; Nr. 986433, dt. 16.08.16; Nr. 986935, dt. 17.05.15; Nr. 986939, dt. 17.05.15; Nr. 986048, dt. 13.08.15; Nr. 986100, dt. 23.11.15, leje për godina banimi, në të cilat u konstatua se sipërfaqja e parcelës ndërtimore tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>”.

Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por që gjithsesi i ka kaluar në pronësi me anë të lejes së legalizimit. Sipërfaqja që është dhënë tepër mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo

më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>” dhe pikën 1/c “Kur për shkak të përmasave ose plan vendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.”

Në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/c, për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, atëherë diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës përsecilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr.89, datë 03.02.2016.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 17, pikat 1/a,c.

***Vlera prej 577,814 lekë lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë “Shtet” për godina banimi, të shitur subjekteve informale, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

**-Në 1 rast, në ZK nr. 2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate,me adresë: Fshati“Ostren i Madh”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, Zona Kadastrale nr. 2846, nr. Pasurie 1691/1, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit, në kushtet, kur sipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr. 417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr.1755, datë 05.04.2016, “kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr. 1691, regjistruar në vol.8, faqe 182, të ZK 2846, Bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”:5031 m<sup>2</sup>.

Në katë rast për nuk lejohet lëshimi i lejeve të legalizimit, dhe konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullimore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullimor”, nenet 10 dhe 17.

**-Në 6 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, nr. 2312**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr. 986004, datë 18.07.2015; nr. 986095, dt.12.11.15; nr. 986141, dt. 26.01.16; nr. 986125, dt.21.12.15; nr. 985954, dt.30.06.15; nr. 986139, dt.26.01.16; nr. 986104, dt.25.11.15, në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, në kundërshtim me me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, ka lëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), në kundërshtim me urdhrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

-Në 4 raste, në zonat kadastrale nr. 2161 Klos dhe nr. 8612 Bulqizë, ka lëshuar lejet e legalizimit nr. 985935, dt.17.05.15., nr.986048, dt.12.05.15, nr. 986181, dt. 21.03.16 në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtësë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr.258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”.

## D. INDIZIE PËR KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, **për shkeljet e konstatuara dhe pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal, të dërgohet për indicie i gjithë materiali i përgatitur mbi bazën e shkeljeve të konstatuara, veçanërisht për legalizimet e objekteve në afërsi të lumenjve, zona të mbrojtura, rrugëve nacionale, përrenjve e kanaleve kryesore kulluese dhe legalizim mbi objekte shtetërore, duke tjetërsuar pronën publike, etj., për këta persona:**

1. *Sh.T. ish drejtor i DR Aluiznit Qarku Dibër,*
2. *N. K. ish drejtor i DR Aluiznit Qarku Dibër,*
3. *F. R specialist/hartograf,*
4. *V. Gj specialist/juriste.*

1. *Sh.T. ish drejtor i DR Aluiznit Qarku Dibër konkretisht për:*

**Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t,Qarku Dibër,**lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë në vlerën **26, 517,252lekë, nuk kabashkëpunim** në nivelin e duhur me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore me Bashkinë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos, në kundërshtim me nenin 27,pika (ç) e ligjit 9482,datë 03.04.2006,i ndryshuar

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore, **331 dosje** duke shkelur afatet ligjore, në kundërshtim me nenin 28, të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

- Nga 527 objekte, për **491 objekte**, DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër, **nuk ka nisur shkresat për daljen e VKM-ve** dhe në dosjet e audituara nuk gjendet as një lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë.

-Në 3 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Në 4 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik). Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtimet të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin

nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

**-Në 2 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i liqenit të Ulzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më të vogël se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 1 rast**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

**-Në 2 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga Liqeni i Lurës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 2 raste**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose “PPV”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet *“Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.”*

**-Në 2 raste**, ka miratuar leje legalizimi për objektet pa u nga subjektet penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuesenë vlerën 2% të çmimit minimal fiskal për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe në vlerën 5% të çmimit minimal fiskal për veprimtari socio-ekonomike sipas nenit 43 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Mos shlyerja e penaliteteve për sipërfaqet shtesë të ndërtuara nga subjektet **ka shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 966,251 lekë**;

-Për shkelje dhe konflikt interesi në dhënien e lejes legalizimit datë 08.10.2017, për ndërtimin informal “*godine social-ekonomike 2-kat*”, Maqellarë, pasuria 119/1/1, ZK 2592, pasi distanca e objektit nga rruga nacionale pasqyrohet 1,25 metër nga 10 metër që duhej, si dhe leja është nënshkruar nga drejtori për vëllain e tij,

**-Për shkelje në dhënien e lejes legalizimi datë 14.9.2017, ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik**, pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, pasi ndërtimi informal prek dhe çënon zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore, të unazës së qytetit, sipas shkresës të bashkisë nr.4068/1, datë 7.9.2017. Për pasojë nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga e unazës të qytetit, pasi ndodhet 2,5 metër larg saj, në vend që të jetë jo më pak se 5 m, në kundërshtim me pikën 66 dhe 44 të Rregullores së Urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, me

nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar ligjin nr.50/2014 dhe me VKM nr.756 datë 10.2016 pika 2 /i/gj.

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimi datë 13.12.2017, për ndërtimin informal “*shtesë 1-kat ne objektin ekzistues 1-kat për aktivitet*” Maqellare, pasuria 60/27/1, ZK 1384, pasi shtesa është ngjitur objektit ekzistues pikë karburanti dhe paraqet rrezik zjarri, në kundërshtim me nenin 35 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 të ndryshuar, me VKM nr.756 datë...10.2016 pika 2 /gj dhe 3,

-për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 2 raste, pasi shkallëtcenojnë hapësirat publike, përkatësisht: pasuria 11/158, ZK 2932 dhe 127/24, ZK 1591, në kundërshtim me nenet 27, 31, 39, 41, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, me VKM 280, datë 01.04.2015.

- për shkelje në legalizimin e pasurisë 127/24, ZK 1591, pasi nuk janë respektuar distancat nga rruga nacionale, në kundërshtim me nenet 27, 28, 33, 35, 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006i ndryshuar me ligjin 50/2014, me nenin 25 pika 2 të VKM nr.153, date 07.04.2000 “*Për miratimin e rregullores zbatimit të KRR në RSH*”, me VKM nr.280, datë 1.4.2015,

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimit 27.08.2017, për pasurinë nr.25/80, ZK 2932, pasi subjekti ka përfutur 90 m<sup>2</sup> parcelë ndërtimore nga 35 qe i takon ose tepër 55 m<sup>2</sup> . Poseduesi nuk disponon dokument për marrëdhënien me truallin për pjesën e sipërfaqes 55 m<sup>2</sup>, madje legalizimi isipërfaqes 55 m<sup>2</sup>bie ndesh edhe medeklaratës noteriale datë 29.9.2017 të subjektit.

**-Në 2 raste**, në Zonën Kadastrale nr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.1326, Bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, Bashkia Peshkopi, nr.8612, Bashkia Bulqizë, ka lëshuarlejet e legalizimit: Nr.987070, dt. 08.01.2018, 985017, dt. 28.10.17, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statuset juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezultojnë të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore sidhe të njësisë apo institucioneveshtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet se ndërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNIT Dibrë.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB çmimi 39,767 lekë/m<sup>2</sup> sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016 llogaritet në 6,396,124 lekë.

***Vlera prej 6,396,124 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të ZQRPP dhe ALUZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172.

**-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale nr.2161**, ka lëshuarlejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.



*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale nr.2164**, ka lëshuar lejen e legalizimit: nr.987011, dt. 12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, përsipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhen në afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i Lumit Mat, është më e vogël se 100 m, distancë prej 40 m, brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipërnuk duhejpranuar për legalizimobjektet me sipërfaqen “Truall”.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 14 raste**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr.nr.987070, datë 08.01.2018; nr.985017, dt. 28.10.17; nr.986917, dt. 09.07.17; nr.986901, dt. 25.06.17, nr.986932, dt. 26.07.17; nr.987836, dt. 28.02.18; nr.986838, dt. 16.05.17; nr.986998, dt. 22.09.17; nr.986895, dt. 22.06.17; nr.986936, dt. 27.07.17; nr.986926, dt. 25.07.17; nr.987010, dt. 13.10.17;nr.987011,dt. 12.10.17; nr.986908,dt. 15.07.17; në kushtet e mungesës së inventarëve përkatës të këtyre dosjeve, sipas dokumentacionit dhe numrit të fletëve për çdo dokument, në kundërshtim me Ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, kalëshuar lejet e legalizimit,në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në kundërshtimeligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale**, proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuarvetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), në kundërshtim me urdhrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 1 rast**, ka lëshuar lejen e legalizimit nr.986895, dt. 22.06.17,në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dheDibër, në kundërshtim me VKM nr.258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”.

## **2. N. K. ish drejtor i DR Aluiznit Qarku Dibër:**

**-Në 5 raste**, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distance **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr. 111/2012,datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 9 raste**, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulëzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik). Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime tëçdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni

19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

-**Në 3 raste**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

-**Në 1 raste**, është **legalizuar objekti pa respektuar distancën nga Liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 1 rast**, në një zonë informale të pa miratuar nga KRRTRSH/KKT **ka dhënë leje legalizimi për objektin "Pallat 9 kate"** dhe është bërë kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore, të regjistruar në ZVRPP në zërin kadastral “Pyll”, **duke ndryshuar zërin kadastral nga "Pyll" në "Truall" pa miratimin e autoriteteve përkatëse**. Legalizimi i objektit është kryer në zonën “Territore të tjera”, **për të cilën nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.**

-**Në 1 rast**, *ka legalizuar shtesën anësore 1-kat, me sipërfaqe 29.4m<sup>2</sup>*, në ZK 1326, pasuria nr.4/431, e cila sipas fotove të deklaruesit *paraqitet karabina pa mbulesë me çati apo soletë*.Leja e legalizimit është miratuar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-**Në 2 raste**, ka dhënë leje legalizimi për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup> dhe 250m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë është **dhënë në tejkallim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-**Në 4 raste**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë në pronësi “Shtet” ose “PPV”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar.

-**Në 7 raste**, ka miratuar leje legalizimi për objektet pa u nga subjektet penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën 2% të çmimit minimal fiskal për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe në vlerën 5% të çmimit minimal fiskal për veprimtari socio-ekonomike sipas nenit 43 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Mos shlyerja e penaliteteve për sipërfaqet shtesë të ndërtuara nga subjektet *ka shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,302,079 lekë*.

-**Në 12 raste**, ka dhënë leje legalizimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej **1461.9m<sup>2</sup> në total mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit dhe duke i ndryshuar zërin kadastral nga “Arë” në “Truall”**, në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a.

-**Në 2 raste**, ka kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet e përroit, ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej

**buzës së përroit me pak se 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi;

-Për dhënien e lejes legalizimit datë 06.02.2016, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, për pasurinë 22/104, ZK 2932, pasi ndërtimi informal lokal 1-kat është ndërtuar në rripirën e përroit dhe nuk ka themele dhe qëndron mbi trarë hekuri me rrezik shembje,

-Për legalizimin e ndërtimeve informate në 8 raste, me mungesa të dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe mos plotësim të kushteve për legalizim, pasi ndërtimet informate paraqiten të pa përfunduara, në kundërshtim me nenet 3, 27, 28 dhe 33 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014, konkretisht: për pasuritë nr. 1/343/1, ZK 2161, nr. 2/332, ZK 1326, nr.5/324/1, ZK 2932, nr.5/88/1, ZK 2932, nr.3/141/1, ZK 1326, nr.6/336, ZK 1326 dhe nr. 16/43/1, ZK 2932.

-Për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 5 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre (*shkallët*) cenojnë hapësirat dhe sheshet publike, përkatësisht: pasuria 755/2, ZK 2592, nr. 1/436/1, ZK 2161, nr.14/26, ZK 2932, nr.13/100, ZK 2932, nr.5/523, ZK 1326, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015.

-Për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale brenda dhe jashtë zonave të banuara urbane, në 2 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre nuk kanë respektuar distancat nga rruga nacionale, në kundërshtim me nenet 27, 28, 33, 35, 39 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar me ligjin 50/2014, me nenin 25 pika 2 të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në RSH”, me VKM nr.280, datë 1.4.2015, konkretisht: pasuria 234, ZK 2592 dhe nr.1/232, ZK 2161.

**-Në 13 raste, në Zonën Kadastrale nr. 2161, nr. 2164, Bashkia Klos, nr. 1326, Bashkia Mat, nr. 2592, nr. 2932, Bashkia Peshkopi, nr. 8612, Bashkia Bulqizë**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.986004, dt.16.07.2015, nr. 986320, dt.12.05.2016, nr. 986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016, nr. 986409, dt. 27.07.2016, nr. 986433, datë 16.08.2016, nr.985935, dt.17.05.15, nr.986048, dt.12.05.15, nr.986100, dt.23.11.15, nr.986502, dt.20.09.2016, nr. 986509, dt. 06.10.16, nr. 986456, dt. 02.09.16, nr. 986149, dt. 12.02.16, ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statuset juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezultojnë të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme të njësisë administrative vendore apo qendrore si dhe të njësisive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet se ndërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZIONI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matit sipas EKB, 39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, llogaritet në 40,309,421 lekë.

***Vlera prej 38,591,487 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar”, të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUIZNIT, nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172.

**-Në 4 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, 1326, 2592**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr. 986304, dt. 20.04.16; 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986509, dt. 06.10.16; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Vendimin e KM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në 4 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, nr. 2164, Bashkia Klos, nr. 3959, nr. 1164**, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr. 986777, dt. 23.03.17; nr.986095, dt.12.11.15; nr. 985936, dt.17.05.15; nr.986474, dt.07.03.16 në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për sipërfaqe “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhen në afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatua se distanca e objekteve nga bregu i Lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhetet në segmentin 36 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 4 objektet në sipërfaqen “Truall”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 7 raste, në Zonat Kadastrale nr. 1137, 1326, 2161, Bashkia Klos**, ka lëshuar lejet e legalizimit: Nr. 986008, dt. 16.07.16; Nr. 986408, dt.27.07.16; Nr. 986433, dt. 16.08.16; Nr. 986935, dt. 17.05.15; Nr. 986939, dt. 17.05.15; Nr. 986048, dt. 13.08.15; Nr. 986100, dt. 23.11.15, leje për godina banimi, në të cilat u konstatua se sipërfaqja e parcelës ndërtimore tejkalon 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a ku citohet “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>”.

Kjo sipërfaqe e tepërt është miratuar pavarësisht faktit që përfituesi i lejes së legalizimit nuk ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por që gjithsesi i ka kaluar në pronësi me anë të lejes së legalizimit. Sipërfaqja që është dhënë tepër mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a, ku citohet “*Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>*” dhe pikën 1/c “*Kur për shkak të përmasave ose plan vendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.*”

Në zbatim të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/c, për parcelat ndërtimore që kanë sipërfaqe më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit, atëherë diferenca e sipërfaqes totale me trefishin e ndërtimit duhet të llogaritet me vlerën e tregut të përcaktuar në VKM nr. 514, datë 30.7.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës përsecilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me VKM nr.89, datë 03.02.2016.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 17, pikat 1/a,c.

***Vlera prej 577,814 lekë lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes së parcelës ndërtimore pronë “Shtet” për godina banimi, të shitur subjekteve informalë, mbi 3-fishin e sipërfaqes së bazës së ndërtimit të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

**-Në 1 rast, në ZK nr. 2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate,me adresë: Fshati“Ostren i Madh”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, Zona Kadastrale nr. 2846, nr. Pasurie 1691/1, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit416 m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit, në kushtet, kur sipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr. 417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr. 1755, datë 05.04.2016, “kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr. 1691, regjistruar në vol.8, faqe 182, të ZK 2846, Bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”:5031 m<sup>2</sup>.

Në katë rast për nuk lejohet lëshimi i lejeve të legalizimit, dhe konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullosore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, nenet 10 dhe 17.

**-Në 6 raste, në Zonat Kadastrale nr. 2161, nr. 2312**, ka lëshuar lejet e legalizimit nr. 986004, datë 18.07.2015; nr. 986095, dt.12.11.15; nr. 986141, dt. 26.01.16; nr. 986125, dt.21.12.15; nr. 985954, dt.30.06.15; nr. 986139, dt.26.01.16; nr. 986104, dt.25.11.15, në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, në kundërshtim me me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale,** ka lëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

**-Në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha zonat kadastrale,** proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), në kundërshtim me urdhrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 4 raste, në zonat kadastrale nr. 2161 Klos dhe nr. 8612 Bulqizë,** ka lëshuar lejet e legalizimit nr. 985935, dt.17.05.15., nr.986048, dt.12.05.15, nr. 986181, dt. 21.03.16 në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtesë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr.258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”.

### **3. F. R. specialist/hartograf:**

**Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Dibër,** lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **795 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukture në vlerën **26, 517,252 lekë, nuk ka** bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, me Bashkinë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos, në kundërshtim me nenin 27, pika (ç) e ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar- Nga 527 objekte, për **491 objekte,** DR e ALUIZNI-t Qarku Dibër, **nuk ka nisur shkresat për daljen e VKM-vedhe** në dosjet e audituara nuk gjendet as një lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë.

-Nuk ka ndjekur procedurat ligjore, **331 dosje,** duke shkelur afatet ligjore në kundërshtim me nenin 28 të ligjit 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

**-Në 6 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat,** ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

**-Në 11 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik).** Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtimet të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

**-Në 3 raste,** nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

**-Në 2 raste, është legalizuar objekti pa respektuar distancën nga Liqeni i Luzës,** ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash,** veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për

rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-**Në 1 rast**, nga verifikimi i hartës dixhitale Google Earth, rezulton se ka legalizuar një objekt i cili nuk ishte ndërtuar deri në datën 27.06.2014, pra nuk ekzistonte në atë kohë, e për pasojë duhet të ishte përjashtuar nga legalizimi sepse sipas fushës së zbatimit të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, të përcaktuar në nenin 2 “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”. Pra, **ndërtesa e legalizuar nuk është objekt i ligjit**, për pasojë është legalizuar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-**Në 2 raste**, ka dhënë leje legalizimi për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 176.3m<sup>2</sup> dhe 250m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë **është dhënë në tejkallim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-**Në disa raste, nuk ka paraqitur me vërtetësi nga ana grafike distancat e objekteve** të legalizuara nga lumi Mat, rrugët e kategorisë C, liqeni i Ulzës si edhe nuk ka pasqyruar grafikisht vendodhjen e objekteve në territorin e Zonave të Mbrojtura **duke shmangur qëllimisht përjashtimin e këtyre objekteve nga legalizimi** dhe duke mundësuar kështu legalizimin në kundërshtim me ligjin të këtyre objekteve.

-**Në 1 rast**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet”. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, i ndryshuar ku citohet “*Nëse poseduesi ka ngritur ndërtim informal mbi truallin e një objekti të shembur, që ka qenë në pronësi të tij, ai duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së ALUIZNI-t deklaratën noteriale në të cilën pranon faktin e shembjes. Kjo deklaratë dorëzohet përpara miratimit të lejes së legalizimit dhe një kopje e saj përcillet pranë ZVRPP-së. Kur objekti i shembur rezulton në pronësi të të tretëve ose në pronësi shtetërore, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose çdo dokumenti ligjor pronësie, në deklaratën noteriale poseduesi duhet të deklarojë se nuk është subjekt i veprave penale të parashikuara në seksionin III, të kreut III, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal. Për ndërtimet shtetërore të shembura, institucioni përgjegjës (administrues) detyrohet të kryejë procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit. Për territoret ose për sipërfaqe të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, procedurat e legalizimit kryhen duke njoftuar paraprakisht këto institucione.*”

-Ka mbajtur procesverbal datë 14.04.2015, për rishikimin e distancave të objektit nga lumi e kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, por ky procesverbal është hartuar dhe nënshkruar 14 ditë mbas lejes së legalizimit, që do të thotë që është thjesht formal dhe fiktiv, për arsye se leja e legalizimit ishte dhënë tashmë, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa respektuar distancën nga lumi.

-**Në 1 rast** ka pasqyruar të dhënat e verifikimit në terren sikur objekti të ishte godinë banimi dhe për pasojë leja e legalizimit është dhënë për godinë banimi ndërkohë që faktikisht objekti është magazinë;

-për shkelje në legalizim datë 06.02.2016 për pasurinë 22/104, ZK 2932, pasi ndërtimi informall lokal I-kat është ndërtuar në rrepirën e përroit dhe nuk ka themele por është vendosur mbi trarë hekuri me rrezik shembje, në kundërshtim me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar,

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 31.01.2017, për ndërtimin informal “*godinee kombinuar 3-kat*”, Bulqizë, pasuria 2/122/1, ZK 8612, pasi ndërtimi informal 3-kat nuk plotëson kushtet për legalizim, sepse paraqitet i pa përfunduar, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” i ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin 50/2014,

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 27.08.2017, për ndërtimin informal “*godine shërbimi 1-kat*”, Bulqizë, pasuria 1862, ZK 3694, pasika përdorur 2 standarte lidhur me miratimin e parcelës ndërtimore, sepse nuk ka argumentuarshitesën dhe pakësimin e saj. Kështu ka rritur sipërfaqen e parcelës ndërtimore në masën 836 m<sup>2</sup> nga 646 m<sup>2</sup> që duhej, sipas KPP të ZVRPP, vol 8 faqe 16, ndryshe nga pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 48 m<sup>2</sup> me sipërfaqe ndërtimi 48 m<sup>2</sup>, që nuk është rritur.

-për aplikimin me 2 standarte lidhur me hartimin e genplaneve, pasi *për pasurinë nr.1862* ku është respektuar distanca 46 metër nga rruga nacionale është pasqyruar në genplan, ndryshenga *pasuria 1/436/1*ku nuk është respektuar distanca nga rruga nacionale nuk është pasqyruar në genplan. Gjithashtu për këtë të fundit nuk pasqyrohen saktë kufitarët, madje rrugën nacionale e ka pasqyruar rrugë lagje, për efekt të shmangies të mos respektimit të distancës, sipasproces verbalit konstatimit datë 28.10.2014.

-për mos përcaktimin e distancave të objektit nga 3 kufitarët dhe me rrugën nacionale, sipas procesverbalit verifikimit në terren datë 13.11.2016, për pasurinë 119/1/1, ZK 2592.

-për aplikimin me 2 standarde, lidhur me hartimin e procesverbalit të konstatimit në terren datë 26.05.2017 për pasurinë nr.1862, pasi është hartuar nga 1 person si hartograf dhe specialist i legalizimit, në vend të 2 specialisteve, siç është vepruar në rastet tjera. Kyfenomen është konstatuar dhe në rastet e tjera.

**-Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit,në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuarvetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdhrrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

**-Në 5 raste, në Zonën Kadastralenr.2161, nr.2164, Bashkia Klos, nr.1326, Bashkia Mat, nr.2592, nr.2932, Bashkia Peshkopi, nr.8612, Bashkia Bulqizë,**përlejet e legalizimit: nr.986004,dt.16.07.2015, nr.986334, datë 01.06.2016, nr.986408, dt. 27.07.2016,nr.986048, dt.12.05.15, nr.986509, dt.06.10.16,ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhestatusetjuridikëtë pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë,konfirmojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janëpronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklarata noteriale përprishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”dhe nuk rezulton të jenë zbatuarprocedurat përpasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore si dhe të njësisive apo institucioneveshtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër konstatohet sendërtimet nuk janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duheshin lëshuar nga DR e ALUZNI-t Dibër.

Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Matisipas EKB,39,767 lekë/m<sup>2</sup>, sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016,llogaritet në 15,874,986 lekë.



***Vlera prej 15,874,986 lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë "Shtet" dhe "Pronar i pavërtetuar" të legalizuar, do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje", pika 9.

-Udhëzimin epërbashkët të ZQRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 "Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar" pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar neni 172.

**Në 3 raste, në Zonat Kadastrale nr.2161, 1326, 2592**, përlejet e legalizimit: 986185, dt. 21.03.16; 986509, dt. 06.10.16; 986119, dt. 10.12.15; në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugëautomobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa "a" dhe pika 4, germa "b".

**-Në 2 raste, përlejet e legalizimit: nr.986095, dt. 12.11.15; nr.986474, dt. 07.03.16;** në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, për sipërfaqe "Truall" të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe një sipërfaqe ndërtimore të legalizuar, ndodhënë afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i Lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhetet në segmentin 26 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkueshme.

Sa më sipër nuk duheshin pranuar për legalizim 2 e mësipërme.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

#### **4. Visiola Gjoni specialist/jurist:**

**-Në 4 raste, ka legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i lumit Mat**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 84, pika a dhe b.

**-Në 11 raste, ka legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik).** Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse. Këto veprime bien në kundërshtim me VKM nr.280, date 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar; Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19 dhe Ligjin Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b.

-Në 2 raste, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka **legalizuar një objekt që shkel distancën prej 10m nga kufiri rrugor i rrugës së kategorisë C** të përcaktuar në nenin 4, pika c/i të VKM Nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar.

-Në 4 raste, është **legalizuar objekti pa respektuar distancën nga Liqeni i Luzës**, ku nga verifikimi i hartës vektoriale rezulton se objekti ndodhet në një distancë **më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b.

-Në 1 rast, nga verifikimi i hartës dixhitale Google Earth, rezulton se ka legalizuar një objekt i cili nuk ishte ndërtuar deri në datën 27.06.2014, pra nuk ekzistonte në atë kohë, e për pasojë duhet të ishte përjashtuar nga legalizimi sepse sipas fushës së zbatimit të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, të përcaktuar në nenin 2 “Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”. Pra, **ndërtesa e legalizuar nuk është objekt i ligjit**, për pasojë është legalizuar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-Në 1 rast, ka dhënë leja e legalizimit për “Shtesë në lartësi” duke i kaluar në pronësi subjektit përfitues edhe **parcelën ndërtimore prej 250 m<sup>2</sup>**. Ligji nuk parashikon kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore për rastet e shtesave në lartësi e për pasojë kjo parcelë **është dhënë në tejkalim të kompetencave të ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Dibër duke shmangur qëllimisht procedurat e privatizimit të truallit nën ndërtesë me pronar “Shtet”**. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

-Në 5 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe prej 5% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe shërbimi sipas nenit 43, të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. **Mosshlyerja e penaliteteve nga subjektet ndërtuese, për sipërfaqen shtesë të ndërtuar është në vlerën 1,051,296 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Në 6 raste, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-të e Qarkut Dibër për statusin juridik të pronave për të cilat janë dhënë lejet e legalizimit rezulton se këto pasuri (truall + ndërtesë) janë me pronësi “Shtet” ose pronë e të tretëve. Lejet e legalizimit për këto objekte janë dhënë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime pa leje” i ndryshuar.

-Në 1 rast, ka kryer **legalizim të objektit pa respektuar distancat nga bregu i përroit**, ku sipas dokumentacionit shkresor dhe dixhital, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej **buzës së përroit me pak se 100 metra**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5 dhe Ligjin Nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b;

-për shkelje në lejen e legalizimit datë 31.01.2017, pasuria 2/122/1, ZK 8612, pasi ndërtimi informal 3-kat nuk plotëson kushtet për legalizim, sepse paraqitet i pa përfunduar, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “a” të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar.

-për shkelje në dhënien e lejes legalizimit datë 14.9.2017, ndërtesë 1-kat për aktivitet social-ekonomik, pasuria 23/142, ZK 2932, Peshkopi, pasi ndërtimi informal prek dhe çënon zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore, të unazës së qytetit, sipas shkresës të bashkisë nr.4068/1, datë 7.9.2017. Për pasojë nuk është respektuar distanca e objektit nga rruga e unazës të qytetit, pasi ndodhet 2,5 metër larg saj, në vend që të jetë jo me pak se 5 m, në kundërshtim me pikën 66 dhe

44 të Rregullores së Urbanistikës, të ligjit urbanistikës nr.8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, me nenin 35 dhe 39 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 ndryshuar ligjin nr.50/2014 dhe me VKM nr.756 datë 10.2016 pika 2 /i/gj.

-për shkelje në legalizimin e ndërtimeve informale në 3 raste, pasi ndërtimet dhe shtesat e tyre (*shkallët*) cenojnë hapësirat dhe sheshet publike, në kundërshtim me nenet 27, 31/1/a/b dhe neni 39, 41, pika 2 e 3 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” të ndryshuar, me VKM nr.280, datë 1.4.2015.

**-Në 2 raste, në Zonat Kadastrale**, për lejet e legalizimit: nr.987070, datë 08.01.18; nr.986304, dt. 20.04.16, në kushtet kur pasuritë e legalizuara kufizohen me rrugë automobilistike të kategorisë C, në distancë mbi 10 m largësi prej këtyre rrugëve, në një kohë kur distanca e lejuar për rrugët interurbane të kësaj kategorie është 10 m.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Vendimin e KM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 2, germa “a” dhe pika 4, germa “b”.

**-Në 3 raste**, për lejet e legalizimit: nr.986777, dt. 23.03.17; nr.986095, dt. 12.11.15; nr.987011, dt.12.10.17, në kushtet kur pasuritë e legalizuara dhe parcelat përkatëse, “Truall” të shitur dhe tjetërsuar në truall privat dhe sipërfaqe ndërtimore të legalizuara, ndodhë afërsi të Lumit Mat, ku nga matjet e kryera në hartën vektoriale dixhitale, u konstatuase distanca e objekteve nga bregu i Lumit Mat dhe përroi, është më e vogël se 100 m, distancë që luhet në segmentin 26 m -90 m, distancë brenda së cilës, pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkueshme.

Sa më sipërnuk duheshin pranuar për legalizim 7 objektet në sipërfaqen e përgjithshme prej: “Truall” 1763m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 802 m<sup>2</sup>.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84

-ligjin nr.8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5; neni 3; neni 55.

**-Në 1 rast, në ZK nr.2846**, sipas lejes së legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, për objektin Godinë e Kombinuar 2+1 kate, me adresë: Fshati “Ostren i Madh”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, Zona Kadastrale nr.2846, nr.Pasurie 1691/1, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, ka kryer legalizimin e objektit, në kushtet, kursipas shkresës së ZVRPP Bulqizë nr.417, datë 15.04.2016, në përgjigje të shkresës së DR ALUIZNI-t Qarku Dibër nr.1755, datë 05.04.2016, “kërkesë për statusin juridik...”, rezulton se pasuria nr.1691, regjistruar në vol. 8, faqe 182, të ZK 2846, Bashkia Bulqizë, fshati Ostren i Madh, ka statusin juridik “Shtet”, pasuria: “Kullotë”: 5031 m<sup>2</sup>.

Në këtë rast për nuk lejohet lëshimi i lejeve të legalizimit, dhe konkretisht për z. Skënder Selman Duka, pasi leja e legalizimit nr.986384, dt. 13.07.16, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 1239 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 416 m<sup>2</sup>, është lëshuar në tokë kullimore, kur në toka me këtë zë kadastral (Kullotë), lejohen vetëm për ndërtime të përkohshme, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë ose jepet në përdorim për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike (të përkohshme apo të përhershme duke ndryshuar zërin kadastral).

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, nenet 10 dhe 17.

**-Në 5 raste**, për lejet e legalizimit: nr.986095, dt. 12.11.15; nr.986141, dt. 26.01.16; nr.986125, dt. 21.12.15; nr.986139, dt. 26.01.16; nr.986134, dt. 10.01.16; në kushtet e mungesës së deklaratës personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, për shkak faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

- Në 2 raste, përlejet e legalizimit nr.986181, dt. 21.03.16, nr.986895, dt. 22.06.17, në kushtet kur nuk ka kërkuar konfirmimin e statusit juridik të parcelave ndërtimore dhe pasurive ndërtësë, nga ZVRPP-të Mat dhe Dibër, në kundërshtim me VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 42,

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

- UKM nr.2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, pikat 2 e 3.

-VKM nr .258, datë 4.5.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara”

**-Në pothuajse të gjitha rastet**, në të gjitha zonat kadastrale, kalëshuar lejet e legalizimit, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Proces-verbalet e verifikimit në terren, në pjesën më të madhe janë plotësuar vetëm nga 1 (një) specialist dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim).

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27.

-urdhrat nr.766, datë 10.09.2014 dhe nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**